Gjatë muajit gusht : Donatorë zviceran dhurojnë Lodra për fëmijët e disa zonave rurale : Të gjithë fëmijët e fshatrave Bukovik, Capar, Zhegoc dhe Verbicë e Zhegocit, kanë qenë përfutur të këtij donacioni nga donatori zviceran, Ursi Flusy Stettler.

4. Instituti Lindje Përendim / EastWest Institute

Bashkëpunimi Ndërkufitarë mes Komunave Gjilan – Preshevë – Kumanovë – Tërgovishte

Qëllimet e përgjithshme të Projektit GPKT janë: parandalimi i konflikteve dhe zhvillimi i komuniteteve në katër komunat e GPKT-së - Gjilanit në Kosovë, Preshevës në Serbinë jugore, Kumanovës në Maqedoni dhe Tërgovishtes në Serbinë jugore.

Ky program mikro-grantesh është krijuar për ta:

- o inkurajuar zhvillimin e partneriteteve funksionale ndërkufitare dhe shumëetnike ndërmjet OJQ-ve dhe shoqërisë civile nga anët e ndryshme të kufijve të GPKT-së; dhe,
- o përkrahur ndërtimin e kapaciteteve për shoqërinë civile në këtë zonë dhe zhvillimin e kapaciteteve organizative për implementimin e aktiviteteve ndërkufitare dhe shumëetnike.

5. G T Z & A K K

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), në bashkëpunim me projektin e GTZ-së “Modernizimi i Shërbimeve Komunale” ka ofruar ndihmë financiare për projektet komunale të shkallës së ultë me synimin për përmirësimin e shërbimeve komunale. Në kuadër të projektit “Modernizimi i Shërbimeve Publike”, të financuar nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në Gjilan është nënshkruar një kontratë për subvencione lokale, nga Birgit Stanzel, udhëheqëse e Zyrës Koordinuese GTZ në Kosovë, Gabriele Becker, udhëheqëse e projektit GTZ MMS dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa. Kontrata e nënshkruar ka të bëjë me një ndihmë financiare prej 40 mijë Euro për komunën e Gjilanit, e cila dedikohet ekskluzivisht për pagesën e shpenzimeve lidhur me ndërrimin e dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Selami Hallaqi” të qytetit., Sipas kësaj marrëveshje, projekti fillon në mars dhe duhet të përfundojë më së largu deri në fund të shtatorit të këtij viti., Me datën 09/05/2008 është bere shpallja e tenderit, dërsa me datën 02/06/2008 është bere mbyllja e tenderit .

Gjatë fundit të muajit shtator 2008 Komuna e Gjilanit ka aplikuar prap për vitin 2009 në programin e Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), e cila realizohet në bashkëpunim me projektin e GTZ-së “Modernizimi i Shërbimeve Komunale” . Komuna e Gjilanit ka identifikuar dy projekte të cilat kanë për bazë efikasitetin e energjisë :

- a) ndërtimi – përmirësimi i sistemit të ngrohjes qendrore në shkollën fillore “Selami Hallaqi” nga sistemi me naftë, në atë me dru/thëngjill dhe termoizolimi – fasadimi i objektit
- b) rekonstruimi i ndriçimit publik në qytetin e Gjilanit – vendosja e trupave ndriçues që kursejnë energji

6. Parner Aid International Kosovo - PAI

Komuna e Gjilanit posedon gatishmëri të plotë të përkrahjes së projektit të organizatës PAI pasi që është e nevojshme ngritja e urave të reja të bashkëpunimit reciprok, krijimi e lidhjeve midis organizatave të ndryshme të cilat kanë avancuar dhe po avancojnë ndërtimin e shtëpive për familjet në varfëri të skajshme . Kjo organizatë është e përqëndruar gjatë vitit 2008 në investime në sektorin e banimit dhe rindërtimit .

Në qershor të vitit 2008, Organizata ndërkombëtare PAI e ka zgjedhur Gjilan për të realizuar projektin e qendrës rehabilituese për persona të varur nga droga. Kërkesa e PAI-it për ndarjen e një hapësire prej pesë hektarësh për ndërtimin e qendrës “Streha”, në periferi të qytetit, është shqyrtuar dhe përkrahur si nismë nga Komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, pasi ishin ofruar të dhëna të mjaftueshme për projektin nga organizata PAI. Përfaqësuesi i organizatës PAI, Knut Trachsel tha se vendosja dhe trajtimi i personave në këtë qendër do të jetë falas, pos nëse vetë familjet e tyre dëshirojnë të ndihmojnë. Qëllimi i programit është që pjesëmarrësit të mësojnë dhe aftësohen për të marrë përsipër përgjegjësitë për jetën e vet, pranimi nuk varet nga përkatësia fetare, por që personat e varur nga drogat duhet të tregohen të gatshëm për të jetuar përkohësisht në këtë strehë dhe për t’iu nënshtruar punës dhe terapisë së qendrës, duke e rishikuar vetveten brenda një vizioni pozitiv të së ardhmes.

7. UNDP - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Kthimi dhe ri-integrimi në Kosovë

Me datën 27/02/2008 në kuadër të projektit të rëndësishëm minoritar “Kthimi dhe ri-integrimi i komunitetit rom në komunën e Gjilanit”, kryetari i Komunës Qemajl Mustafa, i ka dëshiruar mirëseardhje familjeve të kthyer në shtëpitë e tyre, në lagjen “Abdullah Presheva”, të zhvendosura pas lufte. Ky projekt (faza e dytë) zbatohet drejtpërdrejt nga Komuna e Gjilanit dhe OJQ “Mercy Corps” me fonde të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim të Qeverisë së Kosovës nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Përmes këtij projekti 19 familje të komunitetit rom janë asistuar me asistencë banimi në lagjen e kësaj komune si dhe 5 familje shqiptare në gjendje të vështirë ekonomike-

sociale. Ky projekt kap shumën 700,914.38 euro. Këto familje të kthyer janë ndihmuar me pajisje për krijimin e të ardhurave të tyre. Ndërkaq kushtet e banimit në këtë lagje janë përmirësuar me shtrimin e disa rrugëve sekondare.

Faza e tretë : gjatë muajit janar 2008 zyrtari për projektie ka përgatitur projektin dhe ka aplikuar për vazhdimin e fazës së tretë të projektit që ka përqëllim kthimin dhe riintegrimin e komuniteti romë në lagjen A. Presheva. Projekti është duke u shqyrtuar nga Ministria e Kthimit dhe UNDP .

Gjatë muajit korrik 2008 fillon implementimi i projektit : “Kthimi dhe ri-integrimi në Kosovë” i cili ka keto karakteristika :

Titulli i projektit :	Kthimi dhe ri-integrimi në Kosovë
Kohëzgjatja e propozuar :	2008 / 2010
Implementues :	UNDP
Monitorus :	Qeveria e Kosovës (MKK dhe MAPL)
Parterët e projektit :	Komunat : Gjilan, Fushë Kosovë, Pejë dhe Istog
Buxheti total :	7 mil € per tri vite (2008-2010)
Te alokuara :	EU : 3.3 mil.€ UNDP : 0.4 mil.€ BKK : 1.1 mil. €, në vitë
Totali i alokuar :	4.8 mil.€
Lokacioni gjeografik :	Kosovë (Komunat : Gjilan, Fushë Kosovë, Pejë dhe Istog)
Kontakti :	UNDP, Qyteza Pejtonë, Prishtinë tel : 038 225 651 ext. 111) z.Kim Vetting, Menaxher i programit
Komponentet e përfshira :	a) rindërtimi dhe kthimi b) asistenca socio - ekonomike c) zhvillimi i komunitetit dhe infrastruktura d) asistenca teknike për komunat e) komponenta e balancimit
Oligimet urgjente të komunave :	a) formimi i grupit lokale të veprimit (GLV) dhe b) grupe komunale për kthim (GKK)

Gjatë muajit shtator 2008 organizohet sesioni informativë për komunitetin e biznesit / behete prezantimi i projektit – komponenta ekonomike / ne takim marin marin pjese perfaqesue ste komunitetit te biznesit, OE, Shoqates se Ekonomistve të Gjilanit, Qendres Regjionale te Puesimit .

Program - projekti “ Kthimi dhe ri integrimi në Kosovë “ parasheh që zyrtaret komunal nga komunat Gjilan, Fushë Kosovë, Istog dhe Pejë të realizojnë një vizitë pune në Bosnje dhe Hercegovinë, konkretisht komunat Gorazhde, Sarajevë, Bosanska Krupa (Bihaq) dhe Mostarë, ku është duke u realizuar faza e tretë e një projekt i tillë i quajtur “ Sutra ”, vizita pune në B&H është bere nga data 22/09/2008 deri më datën 26/09/2008 .

UNDP / EGB – programi i gjenerimit të punësimit

Me datën 05.02.2008, zyrtari i projekteve ka aplikuar në Qendren Regjionale të Punësimit në Gjilan – konkretisht në Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP - EGB) që implementohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) programi : Program projekti i Gjenerimit të Punësimit - krijimi i vendeve të punës Asistencës për Praktikant

Programi përqendrohet :

- në punësimin e të posa diplomuarve të cilët janë pa përvojë pune, por që janë të regjistruar (lajmëruar) në Qendrën Regjionale të Punësimit në Gjilan .

Ne programin e UNDP ne bashkëpunim me Qendren Regjionale te Punësimit kemi angazhuar katër (4+2) praktikanët të profileve të ndryshme (sipas nevojave të komunës) të cilët kanë filluar punën gjatë muajit shkurt (4) dhe maj (2) . Praktikantët e do të marrin një pagë mujore në vlerë 100 € në muaj për periudhën prej 4 muajore. Gjatë fundit të muajit gusht kan filluar praktiken edhe 3 praktikant, ata do të marrin pagë mujore në vlerë 100 € në muaj për periudhën prej 4 muajore pra deri me 27.12.2008.

Obligimet :

UNDP - Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim :

n është e obliguar të siguroj pagën mujore prej 100 € në xhirollogarin e praktikantit

KK – Kuvendi Komunal :

n është i obliguar të siguroj vendin e punës ku praktikanti do të kryej praktiken dhe të përcjell vijushmërinë në punë .

8. USAID - Unitet States Agency for International Development

Me datën 10/05/2008 në Gjilan, në praninë e përfaqësuesve të USAID-it, zyrtarëve komunalë si dhe një numri të konsiderueshëm të afaristëve, u bë finalizimi i marrëveshjes ndërmjet USAID-it, në bashkëpunim me KEK-un dhe kompanisë për prodhimin e kabllove elektrike “CF-Progresi” për furnizim 24 orë me energji elektrike. Pronari i firmës, Hevzi Xhelili, me këtë rast ka falënderuar USAID-in dhe autoritetet përgjegjëse të KEK-it që kanë kontribuar në realizimin e kësaj marrëveshje, e cila atyre iu krijon kushte për kontribut më të madh për komunën dhe furnizim më të mirë dhe kualitativ të tregut me prodhimeve të “Progresit”. Nga ana e tij, Martin Wood, përfaqësues i USAID-it, duke folur për këtë projekt, ka thënë se askush nga ju nuk mund ta merrni me mend se realizimin e këtij objekti, të nisur dy vite më parë, deri më tani e ka penguar një ndërtesë ilegale. Në emër të KEK-it, Petrit Pepaj ka thënë se realizimi i këtij investimi, tash e tutje, jo vetëm ndërmarrjes “Progresi”, por 21 bizneseve të zonës industriale do t’i garantojë furnizim 24 orë me energji elektrike. Përndryshe, kjo kategori e konsumatorëve të energjisë elektrike quhet kategoria A+.

9. Organizata Ndërkombëtare Mercy Corps - CMI

Që nga tetori i vitit 2003 organizata jo qeveritare Mercy Corps program i USAID-it vepron në komunën e Gjilanit, në sajë të bashkëpunimit të mirë janë realizuar disa dhjetra projekte të gjitha sektorve .

Prej viti 2003 e deri në vitin 2007 në komune të Gjilanit janë implementuar 7 projekte në infrastrukturë, të cilat përfshijnë: Nxemja qendore për shkollën në fshatin Malisheve, Ndërtimi i aneksit të shkolles në fshatin Budrige e Ulet, Rregullimi i fontanes dhe platos në fshatin Kufce e Eperme, Rehabilitimi i shkolles Musa Zajmi në qytetin e Gjilanit, Asfaltimi rrugës në fshatin Livoq i Poshtëm, Rregullimi i oborrit të shkolles në fshatin Kufce e Eperme, Rehabilitimi i qendres së kultures në fshatin Partesh .

Qëllimi i programit është :

- krijimi i kushteve për kthim dhe riintegrim të sigurtë dhe të qëndrueshëm të minoriteteve

Programi ka për qëllim të ndihmon zyrtarët komunalë në përmisimin e kushteve për kthim si dhe ndihmon në procesin e reintegrimit, një kohësihtë programi do të mbështesë përmirësimet infrastrukturore në komunën tonë

Gjatë vitit 2008 organizata jo qeveritare Mercy Corps (CMI) ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit dhe do të implementohen edhe këto projekte në infrastrukturë që janë identifikuar si projekte prioritare nga ana e komunitetit të këto janë:

1. Ndërtimi i fushes së sportit në fshatin Budrige e Ulet (S)
2. Ndërtimi i fushes së sportit në fshatin Pasjan (S)
3. Ndërtimi i fushes së sportit në fshatin Stanishor (S)
4. Ndërtimi i fushes së sportit në fshatin Makresh (S)
5. Ndërtimi i fushes së sportit në fshatin Koretishtë (S)
6. Ndërtimi i ambientit të jashtëm shkollorë (lojra) Kufca e Epërme (S)
7. Rehabilitimi i Qendres së Kulturës në fshatin Partesh (S)

Vlera e të gjitha investimeve të Organizatës Mercy Corps është : 224,072.29€ ndërsa participimi i Komunes së Gjilanit është 4,000 € .

Gjatë muajit korrik 07-13 / 2008 kompania nderkombtare e sportit NIKE ka mbështetur aktivitetet sportive në tri komunat e regjionit të Gjilanit (Gjilan, Artanë dhe Dardanë), aktivitete sportive janë mbajtur në sallën e sporteve “Bashkim Selishta” dhe në objektin e shkollës fillore “A.Ajeti” në Gjilan . Implementues i projektit është organizata nderkombtare Mercy Corps / USAID

Skema e klubeve pjesëmarrse :

No	Team Name	Place	NO Playe	Coach	Contact Person	Phone No	Sport Type	Ethnicity	GJILAN/GNJILANE
1	KV ARSENAL	Përlepnice	10	1	Fatbardhë Hajrullahu	044 783 183	Volejbolli	Shqiptarë	
2	KV BOZUR	Shillovë	10	1	Ljubomir Stojanovic	063 7389 312	Volejbolli	Serb	
3	KV BRESALCI	Bresalc	10	1	Bashkim Sylja	049 633 630	Volejbolli	Shqiptarë	
4	KV LIRIA	Pogragjë	10	1	Lorik Ilazi	044 125 999	Volejbolli	Shqiptarë	
5	KV MASINAC	Kuvçë	10	1	Kostic Jovana	064 391 20 89	Volejbolli	Serb	
6	KV NAZIM HIKMET	Dobërgan	10	1	Xhemile Hajdari	044 435 636, 044 331 036	Volejbolli	Shqiptarë	
7	KV STUDENTI	Malishevë	10	1	Hakile Musliu	044 589 955	Volejbolli	Shqiptarë	
8	KV STANISOR	Stanisor	10	1	Dobriboje Djordjevic	044/543-492	Volejbolli	Serb	
9	KF GIMNAZIJA	Pasjane	10	1	Aleksandar Jevtic	064 450 7593	Futboll	Serb	
10	KF CERNICA	Cernicë	10	1	Adnan Hoxha	044 321 362	Futboll	Shqiptarë	
11	KF DARDANICA	Zhegër	10	1	Alban Rrahmani	044 342 709, 049 215 571	Futboll	Shqiptarë	
12	KF DELFINI	Kuvçë	10	1	Sinisa Savic		Futboll	Serb	
13	KF EDUKIMI	Velekincë	10	1	Muhamet Pajaziti	044 490 970	Futboll	Shqiptarë	
14	KF LLASHTICA	Llashticë	10	1	Naser Ibishi	044 357 722	Futboll	Shqiptarë	
15	KF MALËSIA	Kishnapole	10	1	Shaban Murati	044 782 567	Futboll	Shqiptarë	
16	KF MILAN	Shillovë	10	1	Miodrag Atanackovic	063 7368 217	Futboll	Serb	
17	KF PEGAS	Livog i Poshtëm	10	1	Kujtim Arifi	044 679 284	Futboll	Shqiptarë	
18	KF PËRLEPNICË	Përlepnice	10	1	Selatin Bajrami	044 132 341	Futboll	Shqiptarë	
19	KF STANISOR	Stanisor	10	1	Dobriboje Djordjevic	044/543-492	Futboll	Serb	
20	KF TEHNICAR	Kuvçë	10	1	Zoran Denic	064 454 2370	Futboll	Serb	
21	KF VËRBICA E ZHEGOCIT	Verbicë	10	1	Hetem Sejdiu	044 710 339	Futboll	Shqiptarë	

Në fund të shtatorit 2008 përfundon programi i organizatës jo qeveritare Mercy Corps (MISI), gjatë përmbjlljes së programit kanë qenë të ftuar kryetarët e komunave dhe zyrtarët komunal të komunave që kanë qenë e programit Misi si dhe përfaqësues të strukturave politike të Kosovës, në përmbjllje ka marrë pjesë edhe Ambasadorja e Zyrës Amerikane znj. Tina Kaidaov .

10. Agjencioni Zvicran për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

Më 21 shkurt, në Prishtinë është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit në mes të Qeverisë Zvicerane dhe Ministrisë së Energjetikës, për ndërtimin e Trafostacionit 110/20 KV. Ky projekt është dhuratë e Qeverisë Zvicerane për rajonin e Gjilanit në vlerë prej 8 milion e 160 mijë ChF. Marrëveshjen e mirëkuptimit kanë nënshkruar Jorg Al Reding – ambasador i Zvices në Prishtinë, Johachim Rucker – kryeadministrator i Kosovës, Justina Pula-Ministre e Energjetikës në Qeverinë e Kosovës, Qemaj Mustafa - kryetar i Komunës së Gjilanit dhe Remzi Shahini – menaxher i KEK-ut. Ky projekt do të përfundojë gjatë deri në vitin 2010 dhe për Gjilanin do të thotë shumë sepse, Gjilani me rrethinë do të furnizohet me rrymë kualitative dhe do të ndihmohet zhvillimi i qytetit.

11. Qeveria Sllovene (Iskra)

Me ndihmën e donatorit slloven, i cili ka investuar rreth 70 mijë euro, sot në trafostacionin 35/10Kv "Gjilani IV" është inauguruar puna provuese e projektit “Komandim nga distanca”. Me këtë projekt, tash e tutje është krijuar mundësia e komandimit, përcjelljes së sinjaleve dhe alarmeve në këtë trafostacion nga një qendër dispeçerike, si dhe mundësia e monitorimit të këtij trafostacioni nga qendra dispeçerike në Prishtinë si dhe nga drejtorja e distribucionit në Gjilan. Kjo ngjarje përkon edhe me 9 vjetorin e rikthimit të punëtorëve të KEK-ut në vendet e tyre të punës, pas dëbimit me dhunë nga forcat serbe. Ndërkaq, përfaqësuesi i kompanisë sllovene “Iskra”, Igëll Dikell Bak, duke shpalosur qëllimin e këtij investimi, të parin e këtij lloji në Gjilan, ka thënë se me këtë, realizohet kontrollimi i gjithë rrjetit nga një lokacion i vetëm, duke e ulur kështu gabimin e faktorit njeri. Më këtë hap, ka thënë z. Igëll, ne po e ngrisin reputacionin e “Iskrës” këtu në Kosovë.

12. Qeveria Holandeze - Organizata Qeveritare “PUM”

Komuna e Gjilanit është e interesuar të marrë pjesë në projektet PUM-it për arsyeje se është e nevojshme ngritja e urave të reja të bashkëpunimit reciprok, krijimi e lidhjeve midis institucioneve të ndryshme të cilat kanë avancuar dhe po avancojnë zhvillimin, sidomos në sektorin e ambientit .

Në qershor 2008, Organizata e njohur qeveritare holandeze “PUM”, në kuadër të ndihmave për zhvillimin e shteteve në tranzicion, ka shprehur interesim për të ndihmuar në ndërtimin e parkut të qytetit në Gjilan, konkretisht në zbulimin e tij. Holanda, si vend i njohur në botë për prodhimin e luleve dhe bimëve dekorative, për mes organizatës PUM do të dërgojë në Gjilan një ekspert të dizajnit të parkut,

për ta përcaktuar strukturën e luleve dhe bimëve tjera dekorative, në mënyrë që “parku i qytetit të Gjilanit të bëhet i bukur dhe atraktiv, ashtu si parqet e Holandës e jo qendra e një qyteti kaq të bukur si Gjilani, të jetë kaq e betonuar”.

13. USAID - Unitet States Agency for International Development

Gjatë muajit shtator 2008 filon programi i ri USAID-it për të aftësuar të rinjtë për mundësi punësimi, programi do të implementohet nga organizata Mercy Corps me seli në Prishtinë. Projekti për Mbështetjen e Udhëheqësve të rinjë të Kosovës është program tre vjeçarë që do ti ndihmojë të rinjtë e moshës 15-26 vjet nga komunitetet e ndryshme të Kosovës që të bëhen pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e një të ardhme të shëndetshme dhe të përbashkët për ta dhe për komunitetet e tyre. Komponentet e përfshira në projekt janë: Shqetsimet kryesore të rinisë në Kosovë, Siguria ekonomike, Pjesëmarrjen qytetare - avokim, Pajtimin nëdërtnik ertnik, pastaj afësim profesional dhe të ndërmarrësis, mobilizim të komunitetit etj. Programi do tju ofroj pjesëmarrësve mësim praktikë dhe punë praktike në mënyrë që të ofrohen mundësi për të rinjtë në botën reale

14. USAID - Unitet States Agency for International Development

Programi : Iniciativa për Komuna Efektive– Effective Municipalities Initiative (EMI)

USAID-in dhe MAPL konkretisht programit “Iniciativa për Komuna Efektive ” (IKE) që ka për synim t'i inkurajojnë dhe shpërblejnë komunat të cilat bëjnë përpjekje për të përmirësuar performancën komunale. Në bazë njoftimit dhe prezentimit të programit nga ana e USAID-it gjatë fundit të muajit korrik, Komuna e Gjilanit ka shprehë interesim dhe ka aplikuar në programin Fondin Stimulues - Iniciativa për Komuna Efektive që ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Konkurim në Fondin Stimulues-Iniciativa për Komuna Efektive (Faza e parë) data : 27/08/2008

Komuna e Gjilanit ka identifikuar dy projekte të cilat kanë për bazë përmirësimin e shërbimeve për qytetarët :

- Krijimi - sistemi i sporteleve në Drejtorin e Administrates së Përgjithëshme
- Furnizimi me bateri për nevojat e serverve në Qendrën për Shërbim Qytetarëve dhe Instalimi i WEB Softuerit në të gjitha drejtorit komunale

Me datën 30/10/08 kemi pranuar shkresën zyrtare nga programi USAID - Fondin Stimulues - Iniciativa për Komuna Efektive (USAID/IKE),se projekti : Krijimi - sistemi i sporteleve në Drejtorin e Administrates së Përgjithëshme, është aprovuar dhe pritet të implementohet gjatë muajit janar – shkurt 2009.

Konkurim në Fondin Stimulues-Iniciativa për Komuna Efektive (Faza e dytë) data : 29/12/2008

Lista e projektë propozimeve për Fondin Stimulues - Iniciativa për Komuna Efektive (USAID/IKE)

Nr.	Emri i projektit, përshkrimi dhe qëllimi	Shuma €
01	Rregullimi dhe instalimi i nxehtës qendrore Teatri Kombëtar – Gjilan	27,736
02	Furnizimi me bateri për nevojat e serverve në Qendrën për Shërbim Qytetarëve dhe Instalimi i WEB Softuerit në të gjitha drejtorit komunale	14,493
03	Furnizimi me lektura shkollë dhe rafta i shkollës fillore “Dëshmoret e Kombit “ ne fshatin Livoq i Ulët, shkollës fillore “Afërdita “ ne fshatin Sllakovc, shkollës fillore “Agim Ramadani” ne fshatin Lladovë, shkollës fillore “Thimi Mitko” Gjilan, shkollës fillore “ Emin Duraku “ ne fshatin Malishevë,	19,880
04	Ndërtimi i urës mbi Lumin Përlepnicë në fshatin Kmetoc	24,663
05	Ekzekutimi i punëve ndërtimore për aneksin dhe Furnizimi me lektura shkollë dhe rafta i shkollës fillore “ Esat Berisha” në fshatin Llashticë	14,557

15. Turkish International Cooperation & Development Agency (TIKA)

Me kërkesë të zyrtarit për projekte dhe në bashkëpunim të mirë me Organizatën Qeveritare Turke TIKA - Turkish International Cooperation & Development Agency - Prishtinë, organizat TIKA ka ndarë 4250 kg foli (llastik) që janë dhënë Komisionit për shpërndarjen e folisë i formuar nga zyra e kryetarit dhe Drejtorisë së Bujqësis dhe pylltarisë, ku do të përfitojnë 170 familje x 25 kg (100 m2) = 4250 kg .

Projekte ka pasur këto keto karakteristika :

EMRI I PROJEKTIT : Zhvillimi i bujqësisë

QËLLIMI :

- Furnizimi i bujqëve me foli plastmasi për serra

- Shfrytëzimi maksimal i potencialit njerëzor edhe atij ekonomik
- Plotësimi i nevojave të qytetarëve tanë me ushqim të shëndoshë
- Ngritja e Mirëqenjes Sociale

16. Union of Turkish World Municipalities (TDBB)

Asociacioni i Komunave Turke në Botë (TDBB) ku Komuna e Gjilanit është e përfaruar është krijimi i një qeverisje lokale efikase, të qëndrueshme, përmes përpjekjeve të përbashkëta me komunat, ku përmes tyre të arrihet një performancë e kualitetit të lartë në shërbimin e nevojave për anëtarët e saj.

Asociacioni i Komunave Turke në Botë ka karakter Profesional e assesi politik, po ashtu vlen t'ju përkujtoj se shteti i Turqisë, çdo ditë e më tepër po bëhet fuqi e zhvillimeve politike dhe ekonomike në rajon, kjo tregon se Turqia do të jetë faktori kryesor i integriteteve sidomos të shteteve të sapoformuara . shiko “ www.tdbb.org.tr “

Me kërkesë të zyrtarit për projekte dhe në bashkëpunim të mirë me TDBB – Asociacionin e Komunave Turke në Botë , një mijë pako ushqimore si dhe 250 shtretër kanë ardhur të mërkurën (15.10.2008) në Gjilan, si ndihma nga Turqia për nevojtarët e këtushëm, të cilat janë grumbulluar në komunën Pendik të Stambollit.

Me kërkesë të zyrës së projekteve dhe me aprovim të Komiteti të Shëndetësisë, 150 shtretër (jogi) - janë dhënë Spitalit Regjional të Qytetit të Gjilanit, Remzi Sheker, nënkryetar i Komunës Pendik, tha se kjo ndihmë në ushqime dhe shtretër shpreh ndjenjat vëllazërore të popullit turk për popullin e Kosovës, duke premtuar se bëmirsia do të vazhdojnë deri atëherë kur Kosova nuk do të ketë më nevojë për ndihma. “Urojmë që kjo të ndodhë sa më shpejt”,.

17. Trupat e mbrojtjes së Kosovës (TMK) zona e VI & International Organization for Migration • (IOM)

Me qëllim që yllkave dhe fatosave të IP “ Ardhmeria I” tu krijohet kushte me te mira Organizata Holandeze IOM ne bashkëpunim me TMK përfunduan projektin per ndertimin e klasve verore ne oborrin e kësaj çerdhe, vlera e projektit eshte 12.500 €, IOM dhe TMK ka realizuar edhe disa dhe tra projektet ne Komunën e Gjilanit si rregullimi i para hyrjes së shkollën fillore ‘ Liria “ ne Pogradje e cila eshte realizuar ne bashkëpunim me KFOR-in Amerikan .

18. CDF – Fondi për Zhvillimin Komunitar & USAID - Unitet States Agency for International

CDF dhe ka marrë një grant ng USAID qe ka perqellim të investoj një pjesë të fondeve për të muluar pagesat sipas kontratës për projektin :

- Rrethoja e oborrit të shkollës “ Ibrahim Uruçi “ në fshatin Bresalcë – Lagjeja Mirëve dhe
- Sanimi i rrugës dhe urës pran rrugës Budrikë – Pasjanë

Data e shpalljes së ftesës për ofertë është : 17/12/2008. Data e mbylljes së ftesës për ofert është : 13/01/2008, Numri i projektit : NCB02/08

19. Cooperative Housing Foundation CHF dhe Unitet States Agency for International USAID

CHF – Organizat Angleze ka marrë një grant ng USAID qe ka perqellim të investoj në zgjerimin e hapsirave shkollore, nga ky donacion arsimit Gjilanas që po përballet me mungesë të hapsirës për mësim do të përfitoj nga ky program, pra qellimii ketij programi eshte përmirësimi i hapsirës fizike, gajtë muajtit nëntor 2008 eshte nenshkruar memorandum i mirkuptimit mes Kryearit te Komunes, Ministrin te Arsimit dhe Drejtoreshe se USAIDI-it . Drejtoria Komunale e Arsimit ka evdentuar nevojen e madhe dhe ka paraqitur dy projekte, qe jen edhe ne fokus te të ketij programi per zgjerim te hapsires shkollore : Shkolla fillore “ Abaz Ajeti “ ne Gjilan dhe Shkolla e mesme teknike “ Mehmet Isai “ ne Gjilan

Bashkëpunimi me !

Qeverinë e Republikës së Kosovës - 2008

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) :

Rregullimi i shtratit të lumit "Mirusha" është një nga projektet më të rëndësishme për qytetin e Gjilanit, i cili fillon së realizuari gjatë viti 2007 . Komuna e Gjilanit e ka nënshkruar në Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për rregullimin e shtratit të lumit "Mirusha", me këtë projekt do të arrihet që një moçal kundërmues, siç është bërë ky lumë, të shndërohet në një ambient rekreacioni, që në aspektin hapësinor është jetike për qytetin e Gjilanit. MMPH merrë pjesë në këtë projekt me 225 mijë €uro, përderisa komuna do të bashkëfinancojë me 47 mijë €uro dhe kjo do të jetë vetëm faza e parë e projektit, por që krijon mundësi për të kërkuar donatorë tjerë për rregullimin e tërësishëm të shtratit të lumit "Mirusha" dhe ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për ujra të zeza. Për zgjidhjen e plotë të këtij problemi kërkohen më shumë mjete dhe komuna nuk ka mundësi buxhetore ta përballojë një projekt kaq të madh.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) :

Zyrtari për projekte në bashkëpunim me zyrtarin për ambient ka përgatitur projektin " varrosjen e deponisë së vjetër të qytetit në fshatin Pasjak " dhe i ka dorëzuar Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), e cila ka shpallur tenderin dhe janë duke u ekzekutuar punet nga kompania Labi Prishtinë në vlerën prej 76.400, projekti pritet të implementohet me shumë sukses .

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) :

Gjatë vitit 2007 janë tenderur nga MASHT keto projekte : Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore "Musa Zajmi" Gjilan, Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore "Selami Hallaqi" në Gjilan, ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Bukovik , gjatë vitit 2007 vetëm aneksi i shkollës fillore " Musa Zajmi " ka përfunduar .

Ministri i Arsimit Enver Hoxhaj ka premtuar përfundimin e projekteve të filluara (Selami Hallaqi – Gjilan dhe Nazim Hikmet-Bukovik) dhe ka premtuar ndërtimin e dy shkollave të reja në Gjilan, gjatë një vizite që i bëri kësaj komune gjatë muajit shkurt 2008 . "MASHT-i do të investojë një milion e 100 mijë €uro në Gjilan për ndërtimin e një shkolle në qytet, në lagjen e tetë si dhe një tjetre në fshatin Zhegrë", ka thënë ministri Enver Hoxhaj, në një takim me kryetarin e komunës, Qemajl Mustafa, drejtorin e arsimit dhe kulturës, Ismajl Kurteshi . Shënimi është marrë nga ueb faqja: www.gjilani-komuna.org .

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) : gjatë fillimit të muajit maj 2008 ka shpallur tenderet për për ndërtimin e një shkolle në qytet (lagjeja nr.8) - Komuna me çmimin prej 320 mijë € ka blerë token (shpronsim) për shkollë në lagjen nr. 8, puna ka filluar me datën 06/07/08 si dhe ndërtimin e shkollës fillore "Agim Ramadani" në fshatin Zhegrë" ndërsa në fillim të qershor do të mbyllen tenderet .

Gjatë muajit qershor MASHT ka aprovuar edhe ndërtimin e një shkolle të mesme në kompleksin e shkollave të mesme, për këtë projekt janë alokuar 1 mil€ .

Ministria e Transportit dhe PostëTelekomunikacionit (MTPT) :

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit ka pranuar nga Komuna e Gjilanit, një numër të projekteve që kanë pasqyruar përqendrim : Asfaltimin e rrugëve, të cilat do të krijojnë kushte të mira për të gjithë qytetarët e Komunës sonë . Me datën 05/03/2008, Kryetari i Komunës së Gjilanit z. Qemajl Mustafa së bashku me z.Fatmir Limaj , Ministër kanë nënshkruar marrëveshjet (MiM) për bashkëfinancim për realizimin e fazës së parë të këtyre projekteve :

#	Emri i projektit	Lokacioni	Donator / VI €		Nr. MiM	Gjatësia (L)	Gjersia (B)
1	Asfaltimi i rrugës (Ambulanc-shkollë dhe lagjeja e Hashanëve)	Malishevë	MTPT	Komuna	228/08	943	-
2	Asfaltimi i rrugës në fshatin	Pasjak	MTPT	Komuna	226/08	1452	-
3	Asfaltimi i rrugës : rruga Qarkore – fshati Livoq i Epërm	Livoq i Epër	MTPT	Komuna	219/08	37989	-
4	Asfaltimi i rrugës Pogradje – Dobrosin / brezi kufitarë	Dobrosinë	MTPT	Komuna	227/08	5200	-
5	Asfaltimi i rrugës: Capar – Bukovik dhe Capar – Xhamia	Bukovik	MTPT	Komuna	218/08	2035	-
6	Asfaltimi i rrugëve në Lagjen Dardania II (rruga 6 dhe 7 te fusha)	Gjilan	MTPT	Komuna	220/08	505	-
7	Asfaltimi i rrugëve në Lagjen Kodra e Dëshmorëve – tv Vali	Gjilan	MTPT	Komuna	225/08	-	-
8	Asfaltimi i rrugës Hysen Tërpeza (lagjeja Arëberia)	Gjilan	MTPT	Komuna	224/08	993	-
9	Asfaltimi i rrugës "Fadil Jakupi" (Vetësherbim Pireva – rruga Qarkore)	Gjilan	MTPT	Komuna	223/08	520	-
10	Asfaltimi i rrugës Ponesh-Zhegovc-(Permenderoja)	Zhegovc	MTPT	Komuna	221/08	4843	-
TOTALI : Asfaltimi i rrugëve			1,090,000	-	-	-	-
#	Emri i projektit	Lokacioni	Donator		Nr. MiM	Gjatësia (L)	Gjersia (B)
11	Ndërtimi i urës që lidhë fshatin Livoq i ulët me lagjen R.Cernica	Livoq i ulët	MTPT	Komuna	222/08	10	-
12	Ndërtimi i urës që lidhë fshatin Bilinicë me fshatin Pogradje	Bilinicë	MTPT	Komuna	222/08	-	-

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT) dhe Komuna e Gjilanit kan shpallur tenderet për :

- Asfaltimi i rruges Qarkore Gjilan - Livoq i Epërm L- 3798,50m' (Komuna Gjilan)** Afati kohor për pranimin e tenderëve / kërkesave për pjesëmarrje: data 18/04/2008 (MTPT – e ka shpall tenderin, projekti eshte kontraktuar , vlera e kontraktuar e projektit eshte 343,622.80€, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Eskavatori - Ferizaj)
- Rikonstruimi i rruges lokale Ponesh-Zhegovc, L= 4.842,87 m' (Komuna Gjilan)** Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit / dokumenteve para-kualifikuese: data: 17/04/2008 (MTPT – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 576,345.50 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Tali-Gjilan)
- Rregullimi i urës automobilistike mbi lumin e fshatit Livoq i Ulët, L=10.0m,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 25/04/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 55.644,73 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Gjekonstruktng - Viti)
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Pasjak, L- 1451,81m'** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 13/05/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 157,779.16 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Compania Bejta Comerc)
- Asfaltimi i rrugëve në lagjen Dardania II (rruga VI dhe VII, te fusha) L-505 m' ,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 19/05/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 72,533.50 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Eurotrans-Gjilan)
- Asfaltimi i rrugës "Fadil Jakupi" – Gjilan, L- 520 m' ,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 19/05/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 111,559 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Eurotrans - Gjilan)
- Asfaltimi i rrugës "Kodra e Dëshmnorëve – Tv vali - Varresat " – Gjilan ,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 20/05/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 71,992.93 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Çlirimi-Gjilan)
- Asfaltimi i rrugës "Ambulanc shkollë dhe lagjeja e Hashanëve " – Malishevë L-942,50 m' ,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 26/05/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Compania Bejta Comerc)
- Asfaltimi i rrugës "Capar – Bukovik " – Bukovikë,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 01/05/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Compania Bejta Comerc)
- Asfaltimi i rrugës "Hysen Tërpeza " – Gjilan (lagjeja Arberia) L-993 m' ,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 22/07/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 89,017.80 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Çlirimi-Gjilan)
- Ndërtimi i urës që lidhë fshatin Bilinicë me fshatin Pogradje,** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 29/08/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 14.311,60 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Sllubica)
- Asfaltimi i rrugës Pogradje - Dobrosinë – (brezi kufitarë),** Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 14/10/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 1,101,157.83 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Tali-Gjilan)

MTPT, Pas fillimit të punimeve në ndërtimin e nënkalesës në Bresalc të komunës së Gjilanit, këto ditë, filloi ndërtimi edhe i nënkalesës së tjetër në fshatin Ponesh, në rrugën Prishtinë – Gjilan. Pra, kjo nënkalesë është e dyta me rradhë që ka filluar të punohet këtë vit, prej së cilës dobi do të kenë, në rend të parë nxënësit dhe fëmijët e këtyre fshatrave të cilët që vijojnë mësimet në shkollën fillore përtej

rruge, po edhe vet qytetarët, sepse, më nuk do të detyrohen të kalojnë mbi rrugë ku kalojnë automjetet e shumta, e t'u imponohen rreziqeve, po do të jenë më të lire në ecjen dhe kalimin e kësaj rruge përmes nënkalesës së re.

Këto objekte shumë të rëndësishëm për këto fshatra dhe fshatrat tjerë që gravitojnë atypari, ka këto dimensione: 11x2.60x2.20 metra , që do të thotë se është 11 metra i gjatë, 2.60 i lartë dhe 2.20 hapsirë të lirë për të kaluar. Objekti kushton 27 mijë euro ku investues i këtij projekti është Ministria e Transportit dhe PostëTelekomunikacionit).

Ministria e Transportit dhe PostëTelekomunikacionit (MTPT) :

Me datën 18/08/2008, Kryetari i Komunës së Gjilanit z. Qemajl Mustafa së bashku me z.Fatmir Limaj , Ministër kan nënshkruar marrëveshjet (MiM) për bashkëfinancim për realizmin e fazës së dytë të këtyre projekteve :

#	Emri i projektit	Lokacioni	Donator		MTPT (€)	Komuna (€)	Totali €
1	Asfaltimi i rrugës Mustafë Kokaj – lagjeja Arberia	Gjilan	MTPT	Komuna	64,544	10,506	75,050
2	Asfaltimi i rrugëve Dardania II (rruga e V- rruga Kadri Halimi), Rruga e Gjinollëve dhe rruga Hamdi Kurteshi (rruga te tregu), rruga N.Azemi (Kodra e Dëshmorëve) dhe disa rrugica	Gjilan	MTPT	Komuna	154,250	23,000	177,250
3	Asfaltimi i rrugës Malësia (lagjeja nr.8), lagjeja e Bajs (rruga Ali Huruglica dhe Hasan Tasini) , rruga Fatmir Ibishi (lagjeja Dheu i Bardhë), rruga M.A. Ersoy (mbrapa postes), A.Presheva dhe rruga Zia Shemsiu (te Xhamia e Medresës)	Gjilan	MTPT	Komuna	235,000	35,000	270,000
4	Asfaltimi i rrugës Cërrnicë - Gumnisht (1/2)	Gumnisht	MTPT	Komuna	174,000	26,000	200,000
5	Asfaltimi i rrugës në fshatin Zhegër, fshatin Bresalc (lagjeja te Hoxhovit) dhe në fshatin Vërbicë e Kmetovcit	Zhegër, Bresalc, V. e Kmetovcit	MTPT	Komuna	268,500	43,700	312,200
6	Asfaltimi i rrugës Llashticë - Lladovë	Llashticë	MTPT	Komuna	130,500	19,500	150,000
7	Asfaltimi rrugëve Uglar dhe Pogradje	Uglar / Pogradje	MTPT	Komuna	87,000	13,000	100,000
8	Asfaltimi i rrugës Lagjeja e Muhagjirve – Livoq i Epërm	Livoq i Epërm	MTPT	Komuna	52,200	7,800	60,000
9	Asfaltimi i rrugës Ibrahim Temo (lagjeja Arberia)	Gjilan	MTPT	Komuna	42,400	7,600	50,000
10	Asfaltimi rrugës Përlepnice dhe Kodra e Dëshmorëve	Përlepnice-Gjilan	MTPT	Komuna	92,220	13,780	106,000
11	Asfaltimi rrugës Pogradje - Dobrosin (brezi kufitar)	Dobrosin	MTPT	Komuna	356,000	44,000	400,000
TOTALI € : Asfaltimi i rrugëve – faza e dytë					1,656,614	243,886	1,900,500

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (MTPT) dhe Komuna e Gjilanit kan shpallur tenderet për :

1. Asfaltimi i rrugës “Mustaf Koka” – Gjilan (lagjeja Arberia) L-1.080m', Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 07/07/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 102,095 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Magjistrallja-Gjilan)
2. Asfaltimi i rrugës Lladovë – Llashticë, Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 04/09/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 122,284 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Bejta Comerc)
3. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zhegër (pjesa ka varresate e fshatit), në Bresalc (lagjeja e Hoxhovitë) dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Verbicë e Kmetovcit, Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 05/09/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 327,081 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata: Bejta Comerc)
4. Asfaltimi i rrugëve në fshatin Përlepnice, në fshatin Velekicë (lagjeja Qerimt) dhe rrugëve Kodra e Dëshmorëve dhe Rruga Fadil Jakupi (krahu 1 dhe 2) – Gjilan, Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 04/05/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte : 111.210,89 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Bejta Comerc)
5. Asfaltimi i rrugës Cërrnicë - Gumnishtë, Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 03/09/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte : 203,160 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Zuka)
6. Asfaltimi i rrugës në fshatin Muhaxhirët e Livoqit dhe rrugës Ibrahim Temo në lagjen Arbëria – Gjilan, Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 16/09/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 117,155 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Magjistrallja)
7. Asfaltimi i rrugës në fshatin Uglarë, (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 110,240.68 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Magjistrallja)
8. Asfaltimi i rrugëve ne lagjen Dardania II, rruga e V, rruga Naser Aemi, te tregu dhe disa rrugica - Gjilan Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 27/07/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 182,244 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : EuroTrans Gjilan)
9. Asfaltimi i rrugëve Malesia, Fatmir Ibishi, rruga prapa Postes kryesore, rruga Ali Huruglica dhe Hasan Tasini – Gjilan Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 19/08/2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit eshte 266,241 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Çlirimi – Livoq i Eperme)

10. **Asfaltimi i rrugës Pogragjë - Dobrosinë – (brezi kufitarë)**, Afati kohor për pranimin e tenderëve : data 14/10/2008 (MTPT – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit është 1,101,157.83 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Tali-Gjilan)
11. **Asfaltimi i rrugëve ne fshatin Pogragjë**, Afati kohor për pranimin e tenderëve : nentor 2008 (Komuna – e ka shpall tenderin, vlera e kontraktuar e projektit është 50,251.50 €, emri i operatorit ekonomik që është dhënë kontrata : Eurotrans - Gjilan)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) :

Meqenëse Qendra Rajonale për Trashigimi Kulturore në Gjilan, në bashkëpunim me KK Gjilan dhe MAPL, përkatësisht me mbështetje financiare nga të dyja institucionet e lartpërmendura, gjatë vitit 2007, ka implementuar me sukses projektin (faza e parë) Restaurimi çlirues nga bimësia dhe intervenimi me restauruese me karakter shpëtimi të monumentit – Kalaja e Pogragjës.

MKRS, për vitin 2008 do të jetë donator i dy projekteve madhore për komunën e Gjilanit. Është fjala për vazhdimin e projektit për Kalanë e Pogragjës dhe projektin për gërmime arkeologjike në Tumën e Madhe ilire në Llashticë. Projekti i parë financohet me 40.000 €, ndërsa i dyti me 9300 €, ndërsa komuna participon me 20% në vlerën e projektit (gjegjësisht 9.800€) duke përfshirë edhe ndarjen e tretë financiare prej 2500 € për incizimin e dhjetë (10) monumenteve të kulturës.

MKRS gjatë muajit nëntor ka bërë shpalljen e tenderit për projektin : Rindërtimin e kullës së sahatit në Gjilan – faza e parë e projektit, tenderi mbyllet me datën 20/11/2008.

Ministria e Energjetikës dhe Minjerave (MEM) :

Me datën 21/07/2008 : Gjilani bëhet me stacion sizmologjik Me aktin e përurimit të këtij stacioni, të cilin e ka bërë zv.kryeministri Hajredin Kuqi, Ministria e Energjetikës Justina Pula – Shiroka dh kryetari i Komunës Qemajl Mustafa, Republika e Kosovës edhe zyrtarisht bëhet me qendër të kompletuar sizmologjike.

“Detyra e këtij stacioni është të bëjë monitorimin e aktiviteteve sizmike në territorin e shtetit të Kosovës, rajonit dhe më gjerë. Një gjë të tillë e mundëson ndjeshmëria e madhe e pajisjeve sizmike, të instaluar në këtë stacion, të cilat në mënyrë të saktë përmes komunikimit “wairles” (me internet), i bartin në qendër “online” sinjalet e të gjitha lëkundjeve sizmike , apo çfarëdo qofshin ato”, ka deklaruar drejtori i Institutit sizmologjik të Kosovës Nazmi Hasi, i cili ka shpjeguar në detale mënyrën e funksionimit dhe efektin e aparateve sizmike të instaluar në këtë stacion. Ai me këtë nuk e ka fsheh krenarinë për pajisjet e teknologjisë moderne më të sofistikuar të prodhimit të njohur amerikan “Geotech”, që e kryejnë punën me saktësi të plotë. Stacioni sizmik është vendosur në periferi të fshatit Livoq i Ep, në një territor të përshatshëm gjeor.

Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

Me kërkesë të kryetarit të Komunës së Gjilanit, Ministria për Administrim të Pushtetit Lokal, ka ndarë 100,000 euro për digjitalizimin e shërbimeve në Komunë. Gjendja aktuale e Teknologjisë Informative nëpër të gjithë sektorët dhe nivelet në komunën e Gjilanit, ka shty MAPL të ndajë rreth 100 mijë euro për digjitalizimin e shërbimeve në Komunë, duke u bazuar në një projekt-propozim të Komunës së Gjilanit, për stabilizimin dhe avancimin e digjitalizimit në Komunë. Në këtë projekt – propozim, është konstatuar se, Komuna nuk posedon një paket të integruar ne softuerin aplikativ për kryerjen e shërbimeve për qytetarët, e që është nevojë e ngutshme për një paket të tillë stabil e lehtë të përdorshëm. Poashtu, Komuna ka nevojë të skajshme për ndërrimin e paisjeve të stërvjetëruara dhe për mirëmbajtjen e disa prej tyre, të cilat mund të shfrytëzohen edhe një kohë.

Ministrinë e Pushtetit Lokal, u kemi dërguar kërkesë për mbështetjen me mjete financiare, projekte që kryesisht kanë të bëjnë me zona me popullësi të përzier shqiptaro-serbe, me datën 05/11/2008 MPL ka aprovuar dhe ka nënshkruar Marrëveshjet e Mirëkuptimit me Kryetarin e Komunës për financimin e dy projekteve :

- a) Asfaltimin e rrugës në fshatin Cërrnicë (projekt multietnik), rruga kryesore L-916, rruga kah shkolla L-230 dhe rruga krahu III L-145, dhe rruga krahu L-175, vlera e projektit 97,743, 00 € dhe
- b) Asfaltimin e rrugës në fshatin Koretishtë, (krahu nga shkolla L -155 dhe rruga kryesore L – 645) L - 800 m’, vlera e projektit 56,994.00 €

Gjatë muajit prill 2008, në mes të MPMS dhe Kuvendit Komunal është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit lidhur me punësimin e një numri të punëkërkuarve prej 28+2 vetësh për pastrimin e Lumit Mirusha në një gjatësi prej 2.5 km.

Paga ditore e punëkërkuarve do të jetë 12.5 euro, ndërsa realizimi i projektit do të zgjas 10 ditë. Fillimi punëve do të jetë nga data 16.04.2008. Paga e punëtorëve si dhe sigurimi i mjeteve të punës do të jenë përgjegjësi e komunës.

Programi 2 : gjatë muajit qershor 2008, në mes të MPMS dhe Kuvendit Komunal është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit lidhur me punësimin e një numri të punëkërkuarve prej 29+2 vetësh për projektin : Krasitjen e pishave te penda e Liqenit te Livoqit . Paga e punëtorëve do të jenë përgjegjësi e MPMS – QP, ndërsa sigurimi i mjeteve të punës do të jenë përgjegjësi e komunës. vlera e projektit është 4.000€,

Programi 3 : Me kerkese te Zyres së projekteve programi është vazhduar edhe per nje muaj (muaji gusht) , ne projektin : Krasitja e Pishave te Penda e Liqenit të Livoqit dhe pastrimi i hapsires mbrenda Spitalit Regjional te Qytetit – Gjilan . vlera e projektit është 2.550, ku janë përsuar 20+1 puntor.

Programi 4 : gjatë muajit shtator 2008, në mes të MPMS dhe Kuvendit Komunal është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit lidhur me punësimin e një numri të punëkërkuarve prej 35 + 2 vetësh. (vlera e projektit është : 4.500€)

Qëllimi i projektit :

- n Krasitja e pishave te Penda e Liqenit te Livoqit
- n Pastrimi i sipërfaqes (hapësirës) nga mbeturinat e egra – të rrezikëshme
- n Mbrojtja e flores dhe faunes nga gjendja e mjerushme ekologjike

Obligimet :

Administrata Komonale :

- do ta bëjë sigurimin e mjeteve te punes dhe mekanizmit te nevojshem per kete projekt si dhe mbikëqyrjen e punimeve ne punishte
- po ashtu do ti raportoj MPMS dhe Qendres Regjionale të Punësimit per rrjedhjen e punimeve .

Agjensioni Pyjor i Kosoves (APK) – njesia ne Gjilan :

- dote jetë si organ këshilldhene ne aspektin profesional dhe
- do të jetë mbikqyrse e projektit pas përfundimit – do te garantoj qendrueshmerin e projektit

Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS) dhe Qendres Regjionale të Punësimit – Gjilan :

- sigurimi i pagave te puntorve dhe perzgjedhja e tyre
- si dhe mbikqyrja e vijimit ne pune te punëtorve

Programi 5 : Zyrtari për projekte ka pregatitur projektin, kerkesen per financim dhe i kemi dorzuar Qendres Regjionale të Punësimit dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale per realizimin e projektit “ mbjellja dhe gjelbrimi i e 15 hektarve “ prej të cilave 8 në fshatin Llashticë dhe 7 në fshatin Malishevë - pjesa e djegurë pas luftës, projekti parashef punësimine e 34 punëtorve, MPMS siguron pagat, ndërsa Agjesioni Kosvarë i Pyejeve siguron fidanet dhe paisjet, ndërsa komuna ka marre per obligim sigurimin e nje shuajtje ditore , projekti zgjate nje muaj – pra implementohet gjatë muajit tetor – nëntorë .

Programi 6 : Në bazë njoftimit dhe prezentimit të programit nga ana e MPMS, gjatë fundit të muajit nentor 2008 , kemi për obligim t’ju njoftojmë se :

- Komuna e Gjilanit shprehë interesim dhe aplikon në programin e MPMS – per nxiten e punesimit, krijimit te vendeve te reja te punes – pune publike .

Nr.	Emri i projektit, përshkrimi dhe qëllimi	Shuma €
1	Pastrimi i siperfaqeve, krasitja, nxjerrja dhe stivimi gureve, shtratimi i rruges, pyllëzimi, pergatitja dhe vendosja e ulseve dhe kontenjerve ne Kalan e Pogradjes, angazhimi i 32 punetorve per 6 muaj	43,100
2	Furnizimi i 180 bujqeve me foli plastmasi /llastek/ si dhe furnizmi me pesticide dhe pompa për spërkatje e bimëve si dhe angazhimi i 4 ekspertëve të jashtem per mbrojtjen e bimëve.	22,028
3	Angazhimi dhe përfshirjen e 36 të posa diplomuar - praktikantëve (zyrtarisht të regjistruar) si punëkërkuar në Qendrën Rajonale të Punësimit brenda Shërbimit Civil Komunal Gjilan per nje vite : kater grupe nga 12 praktikant nga 4 muaj	17,280
4	Krasitja e pishave te Liqeni i fshatit Livoq – pjesa e rruges per Gumnishtë, pastrimi i siperfaqes se krasitur dhe largimi i mbeturinave te egra, angazhimi i 35 punetorve dhe 2 mbikqyrsave per 4 muaj	20,844
5	Rehabilitimi, mirëmbajtja e rrugëve rurale dhe mbushja me zhavorë	119,800

Bashkëpunimi me !

Bankat dhe institucionet tjera Bankare - 2008

ProCredit Bank – njësia Gjilan

Zyrtari për projekte ka përgatitur shkresën – kërkesën për ProCredit Bank - filialen në Gjilan për participim në vlerën prej 5.000€ në projektin :

- Rivitalizimi i parkut të qytetit të Gjilanit – i cili është duke u implementuar .

Pasi është aprovuar kërkesa nga ana e ProCredit Bank – filiali në Gjilan, ne kemi pragatitur Marrëveshjen e Mirëkuptimit që është nënshkruar nga :

1. Komuna e Gjilanit në Gjilan të cilën e përfaqëson Qemajl Mustafa Kryetar i Komunës në njërin anë dhe
2. Përfaqësuesit të bankës ProCredit Bank – njësia Gjilan

Obligimet : ProCredit Bank – njësia Gjilan: merrë për obligim që të participojë (të jep donacion) për realizimin e projektit të lartëpërmendur në shumën financiare prej : 5.000,00 € me shkronja: (pesë mijë euro)

ProCredit Bank – donacion prej shumës së lartë cekur do të derdhë në xhirollogarinë e Komunës, pasë nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit: në Xhirollogarinë e Komunës: 10 00 65 00 60 00 00 98)

Pasë barjes ë mjeteve në xhirollogarin e komunës, zyra e projektve ka përgatitur formularin e PIP-it për Ministrin e Ekonomisë dhe Financave – sektori i thesarit, ku mjetet janë bartur në kodin e dedikuar për këte qëllim .

TEB – bnp paribas joint venture njësia Gjilan

Zyrtari për projekte ka përgatitur shkresën – kërkesën për bankën TEB - BNP PARIBAS JOINT VENTURE – njësia Gjilan - filialen në Gjilan për participim në vlerën prej 2.000€ në projektin :

- Rivitalizimi i parkut të qytetit të Gjilanit – i cili është duke u implementuar .

Pasi është aprovuar kërkesa nga ana e bankës TEB – filiali në Gjilan, ne kemi pragatitur Marrëveshjen e Mirëkuptimit që është nënshkruar nga :

1. Komuna e Gjilanit në Gjilan të cilën e përfaqëson Qemajl Mustafa Kryetar i Komunës në njërin anë dhe
2. Përfaqësuesit të bankës TEB – njësia Gjilan

Obligimet : TEB Banka – njësia Gjilan: merrë për obligim që të participojë (të jep donacion) për realizimin e projektit të lartëpërmendur në shumën financiare prej : 2.000,00 € me shkronja: (dymijë euro)

TEB Banka – donacion prej shumës së lartë cekur do të derdhë në xhirollogarinë e Komunës, pasë nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit: në Xhirollogarinë e Komunës: 10 00 65 00 60 00 00 98)

Pasë barjes ë mjeteve në xhirollogarin e komunës, zyra e projektve ka përgatitur formularin e PIP-it për Ministrin e Ekonomisë dhe Financave – sektori i thesarit, ku mjetet janë bartur në kodin e dedikuar për këte qëllim .

NLB banka, njësia Gjilan

NLB – njësia Gjilan : merrë për obligim që të participojë në shumën financiare prej : 3.000,00 € për realizimin e projektit :

Rivitalizimi i parkut të qytetit të Gjilanit – i cili është duke u implementuar . NLB – donacion prej shumës së lartë cekur do të derdhë në xhirollogarinë e Komunës, pasë nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit: në Xhirollogarinë e Komunës: 10 00 65 00 60 00 00 98 . Pasë barjes ë mjeteve në xhirollogarin e komunës, zyra e projektve ka përgatitur formularin e PIP-it për Ministrin e Ekonomisë dhe Financave – sektori i thesarit, ku mjetet janë bartur në kodin e dedikuar për këte qëllim .

Raiffesen banka, njësia Gjilan

Raiffesen Banka – njësia Gjilan : merrë për obligim që të participojë në shumën financiare prej : 9.445,00 € për realizimin e projektit : Rivitalizimi i parkut të qytetit të Gjilanit – i cili është duke u implementuar . Raiffesen Banka donacion prej shumës së lartë cekur do të derdhë në xhirollogarinë e Komunës, pasë nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit : në Xhirollogarinë e Komunës: 10 00 65 00 60 00 00 98 . Pasë barjes ë mjeteve në xhirollogarin e komunës, zyra e projektve ka përgatitur formularin e PIP-it për Ministrin e Ekonomisë dhe Financave – sektori i thesarit, ku mjetet janë bartur në kodin e dedikuar për këte qëllim .

Bashkëpunimi me !

Komunitetin Lokal – praticipimet në projekte ‘ 2008

1. Participim i komunitetit – banorëve të fshatit Bukovikë : Me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore në fshatin Bukovikë, banorët e këtij fshati kanë participuar në projektin : **Asfaltimi i rrugës : “Capar – Bukovik – deri te xhamia e fshatit ” – Bukovikë** me shumën financiare prej : **10.000 €** .
2. Participim i komunitetit – banorëve të lagjes së Muhagjerëve : Me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore në Lagjen e Muhagjirëve, banorët e këtij fshati kanë participuar në projektin : **Asfaltimi i rrugës : Livoq i Epërm – Lagjeja e Muhagjirëve** me shumën financiare prej : **13.200 €** .
3. Participim i komunitetit – banorëve të rrugës Ibrahim Temo – lagjeja Arberia : Me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore, banorët e rrugës Ibrahim Temo – lagjeja Arberia kanë participuar në projektin : **Asfaltimi i rrugës : Ibrahim Temo Lagjeja e Arbëria** me shumën financiare prej : **5.000 €** .
4. Participim i komunitetit – banorëve të rrugës Malësia / lagjeja nr. 8 : Me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore, banorët e rrugës, kanë participuar në projektin : **Asfaltimi i rrugës : Malësia – krah 1 - Lagjeja e nr. 8** me shumën financiare prej : **1.200 €** .
5. Participim i komunitetit – banorëve të rrugës Lagjeja e Qerimeve – ne fshatin Velekicë : Me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore, banorët e rrugës Lagjeja e Qerimeve – ne fshatin Velekicë kanë participuar në projektin : **Asfaltimi i rrugës : Lagjeja e Qerimeve – në fshatin Velekicë** me shumën financiare prej : **1.400 €** .
6. Participim i komunitetit – banorëve të rrugës 28 Nëntori (afër ordinacës Diagnoza) , ne Gjilan : Me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore, banorët e rrugës kanë participuar në projektin : **Asfaltimi i rrugës 28 Nëntori – pjesa te ordinaca Diagnoza – Gjilan** me shumën financiare prej : **1.500 €** .
6. Participim i komunitetit – Shoqata e Zejtareve ne Gjilan : Me qëllim të kompletimit te Qendres Zejtare – ne baze te vendimit te Kuvendit, Shoqata e Zejtareve ka participuar në projektin : **Ndertimi i objekteve ne Qendren Zejtare – Gjilan** me shumën financiare prej : **76,600.86 €**, implementues kompania Mega – Gjilan .

Njoftim :

- Participim i komunitetit – janë të përfshira vetem mjetet të cilat komuniteti në bazë të Marrëveshjeve të Mirëkuptimit (MiM) i ka bartur në xhirollogarin e komunës .

Kronologji e !

Rrjedhave të Komunës - 2008

- Me datën 27/12/2007 : është mbajtur seanca inauguruese e Kuvendit Komunal, ku në mënyrë solemne është bërë bartja e pushtetit të përbërja e re dhe kryetari i ri i Komunës, Qemajl Mustafa, i cili në zgjedhjet e nëntorit doli fitues.
- Me datën 10/01/2008 : Kuvendi Komunal i Gjilanit, mbajti seancën e parë të punës në përbërje të re, ashtu siç pritej, zëvendëskryesues i parë i Kuvendit Komunal u zgjodh Islam Zuzaku (AKR), Drejtorinë për Arsimit dhe Kulturë do ta udhëheq Ismail Kurteshi (PDK), Drejtorinë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim - Ismet Maliqi (PDK), Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit - Omer Daku (AKR), ndërsa Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Maxhide Shaqiri (AAK).
- Me datën 13/01/2008 Komandanti i Brigadës Shumëkombëshe të Lindjes në Kosovë, gjenerali amerikan John Davoren ka premtuar gjatë një takimi me kryetarin e Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa se ushtarët e tij do të jenë afër të gjitha komuniteteve të këtushme, sidomos gjatë muajve të ardhshëm kur pritet të ndodhin procese të rëndësishme për Kosovën. Ndërkaq, Mustafa, i cili e ka njoftuar gjeneralin Davoren edhe për zhvillimet në Kuvendin Komunal të Gjilanit, ka thënë se ndihma shtesë e paqeruajtësve amerikanë është e mirëseardhur në këto momente të përcaktimit të statusit të Kosovës “
- Me datën 16/01/2008 Roli i ombduspersonit në Kosovë është jo vetëm i mirëseardhur, por edhe i domosdoshëm, si për qytetarët, ashtu edhe për institucionet, në këtë fazë të tranzicionit. Kështu ka thënë kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, gjatë një takimi me ushtruesin e detyrës së ombduspersonit, Hilmi Jashari, i cili të martën në Gjilan ka mbajtur “ditën e hapur”. Mustafa i ka premtuar përkrahje në punën e tij, ombduspersonit të Kosovës, me të cilin ka biseduar rreth bashkëpunimit të këtyre dy institucioneve dhe në veçanti me zyrën në Gjilan, e cila gjendet në objektin e Kuvendit Komunal.
- Me datën 17/01/2008 Klubi i Gazetarëve “Beqir Musliu” në Gjilan është më meritori në këtë komunë për promovimin e debatit shumëdimensional, duke qenë kështu një zë i fuqishëm i shoqërisë civile dhe njëkohësisht edhe një kujdestar kritik i pushtetit. Kështu është thënë në një solemnitë rasti, në Gjilan, Veprimtaria shtatëvjeçare e klubit “Beqir Musliu” i cili e shtriu aktivitetin në tërë Kosovën, në Luginën e Preshevës dhe në Kumanovë, u vlerësua lart nga përfaqësues të institucioneve lokale, qendrore, nga AGPK-ja dhe qytetarët. Musa Sabedini, kryetar, tha se këtë rrugëtim shtatëvjeçar e bëjnë bashkë me qytetarët e komunës dhe më gjerë.
- Me datën 31/01/2008 Kryetari i Komunës së Gjilanit z. Qemajl Mustafa, ka pritur në një takim pune në zyrën e tij përfaqësuesin e organizatës Sen Exhidio, Mon Senior Don Sandro Shabotela-n, i shoqëruar nga bashkëpunëtori i tij i ngushtë, drejtori gjeneral i Caritas-it Nacional të Kosovës, Don Viktor Sopi. Kjo organizatë udhëhiqet nga Vinçenco Impala. Përfaqësuesit e Caritas-it gjithashtu diskutuan rreth mundësisë që disa nga nxënësit e dalluar të Komunës së Gjilanit t'u mundësohet që t'i vijojnë studimet në Itali. Kreu i Komunës pohoi se komuna do të shqyrtojë mundësinë për të participuar në ndihmën gjatë studimeve të këtyre nxënësve.
- Me datën 06/02/2008 : Ministri i Arsimit Enver Hoxhaj ka premtuar ndërtimin e dy shkollave të reja në Gjilan, gjatë një vizite që i bëri kësaj komune të martën. “MASHT-i do të investojë një milion e 100 mijë euro në Gjilan për ndërtimin e një shkolle në qytet, në lagjen e tetë si dhe një tjetër në qytezën e Zhegrës”, ka thënë ministri Enver Hoxhaj, në një takim me kryetarin e komunës, Qemajl Mustafa, drejtorin e arsimit dhe kulturës, Ismajl Kurteshi si dhe bashkëpunëtorë tjerë të tyre.
- Me datën 09/02/2008 Edhe në Gjilan kanë filluar përgatitjet për shënimin e ditës së pavarësisë së Kosovës dhe për këtë qëllim është formuar edhe këshilli përkatës. Kryetari i Komunës, Qemajl Mustafa, së bashku me përfaqësues të KFOR-it, TMK-së, SHPK-së dhe OVL-së kanë filluar vizitat nëpër lokalitete të përziera, duke i këshilluar qytetarët që t'i shmangin veprimet e padëshirueshme dhe të mos cenojnë në asnjë mënyrë integritetin dhe as pasuritë e njëri-tjetrit.
- Me datën 09/02/2008 Një projekt i OJQ-së “Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar” pretendon që institucionet komunale në Gjilan t'i bëjë sa më të përgjegjshme dhe sa më transparente kundrejt qytetarëve. Për këtë qëllim do të shërbejnë edhe 15 kuti për ankesa, të cilat do të vendosen nëpër këto institucione. Kutia e parë është vendosur të premten, në objektin e Drejtorisë së Arsimit, duke shënuar në këtë mënyrë fillimin e fazës përfundimtare të projektit “Me transparencë drejt suksesit”.
- Me datën 17/02/2008 Kosova e mbylli rrugëtimin e saj të gjatë për pavarësi, këtë ditë të shumëpritur edhe Gjilani, si komunë e pjesës lindore të Kosovës, e festoi në mënyrë madhështore. Shqiptarët dhe komunitetet tjera festuan bashkë në qendër të qytetit, përderisa komuniteti serb, i cili këtu jeton në disa lokalitete, qëndroi i përmbajtur. Me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, gjilanasve iu ka dërguar një letër urimi humanistja gjermane, Barbara Langmak, e cila dymbëdhjetë vite më parë kishte qenë këtu, për të ndihmuar Kosovën, luftën e UÇK-së si dhe ndërtimin e Kosovës së re.

- Më 21 shkurt 2008, në Prishtinë është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit në mes të Qeverisë Zvicerane dhe Ministrisë së Energjetikës, për ndërtimin e Trafostacionit 110/20 KV. Ky projekt është dhuratë e Qeverisë Zvicerane për rajonin e Gjilanit në vlerë prej 8 milion e 160 mijë ChF.
- Me datën 23/02/2008 Diskutimi për draft-kushtetën e Republikës së Kosovës, në Gjilan, është karakterizuar nga një interesim i madh i pjesëmarrësve për t'i ngritur dilema e pikëpyetje rreth shumë çështje e formulime kushtetuese dhe, anëtarët e komisionit, Fatmir Fehmiu, Lirie Osmani e Kadri Kryeziu, jo në të gjitha pyetjet kanë dhënë përgjigje.
- Me datën 27/02/2008 Hashim Thaçi, kryeministër i Republikës së Kosovës, në rrugëtimin e tij nëpër Kosovë, të cilin ai është duke e bërë për të nderuar në nivel shtetëror dëshmorët, të martën ka vizituar rajonin e Anamoravës. Në Zhegër dhe Gjilan, kryeministri Thaçi, i shoqëruar edhe nga kryetari i Komunës, Qemajl Mustafa, ka bërë homazhe dhe ka vendosur lule te busti i kryetrimt Idriz Seferit si dhe te shtatorete e dëshmorëve Agim Ramadani, Rexhep Mala e Nuhi Berisha si dhe te varrezat e dëshmorëve.
- Me datën 29/02/2008 : Lirohet rruga dykahore pranë stacionit të policisë në Gjilan : Pas insistimit të kryetarit të Komunës, z.Qemajl Mustafa dhe negocimit të mirëpritur që pasoi me SHPK-në (ani se është akt i vonuar), janë hequr rrethojat pranë stacionit policor në Gjilan dhe përfundimisht, ajo rrugë që lidh qendrën e qytetit me lagjet "Zabeli i Sahit Ages" dhe "Arbëria", e që ka qenë kërkesë e kamotshme e qytetarëve të komunës, tash e tutje është në shfrytëzim për kalim dykahor.
- Me datën 04/03/2007 Mosardhja në punë e pjesëtarëve të SHPK-së si dhe e punëtorëve të komunitetit serb në Administratën Komunale, e që është e motivuar drejtpërdrejt politikisht - me aktin e shpalljes së Kosovës Shtet i Pavarur, i dëmton të arriturat shumëvjeqare të shoqërisë së Gjilanit, për të cilat është investuar mund i madh nga komuniteti shumicë (shqiptarët), nga vet komuniteti serb dhe nga ndihma e pakursyer dhe shumëdimensionale e faktorit ndërkombëtar në komunë.
- Me datën 07/03/2008 Kryetari i Komunës, Qemajl Mustafa, ka pritur të premten në një takim përfaqësuesit e organizatës qeveritare turke "Tika", e cila vepron në Kosovë që nga viti 2004, me ç'rast koordinatori i saj, Kursad Mahmat ka ofruar gatishmërinë për të ndihmuar komunën tonë në projekte të ndryshme. Qëllimi i vizitës, sipas z. Mahmat, është që projektet, të cilat i ndihmon kjo organizatë, të përhapen nëpër gjithë Kosovën, duke vënë theksin në investime infrastrukurale, bujqësi, blegtori dhe në arsim.
- Me datën 08/03/2008 Kuvendi i Komunës në bazë të vendimit Nr.01.1095/0101 të dates 12.02.2008 shpall: konkurs për ndarjen e bursave dhe ate 10 bursave për studentë që studiojnë në Gjilan, lartësia mujore 50 €uro, 20 bursave për studentë që studiojnë në Prishtinë dhe qytetet tjera të Kosovës, lartësia mujore 70 €, 10 bursa për studentë që studiojnë jashtë shtetit, lartësia 100 €, 20 bursa për nxënës të shkollave të mesme, lartësia 25 €
- Me datën 10/03/2008, Komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Gjilanit ka premtuar në një dëgjim publik se do të shqyrtohen me shumë kujdes të gjitha vërejtjet dhe propozimet e qytetarëve dhe të shoqërisë civile, për dokumentin themelor të qeverisjes lokale dhe ato që vlerësohen të arsyeshme do të përfshihen në verziolin përfundimtar, përpara se të procedohet për miratim në Kuvendin Komunal.
- Me datën 12/03/2008, Me temën "Qeverisja lokale dhe zhvillimi ekonomik", kryetari i Komunës Qemajl Mustafa, ka mbajtur një ligjëratë para studentëve të Kolegjit Universitar "Fama" në Gjilan.
- Me datën 13/03/2008 Në shenjë respekti për angazhimin e trupave amerikane të KFOR-it për të siguruar një ambient të qetë e të sigurt gjatë manifestimeve të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, bashkë me majorin e TMK-së, Eshref Uruqi, komandant i Brigadës 364, në një darkë solemne, të shtruar me këtë rast, iu kanë ndarë mirënjohje Batalionit Operativ "Task Force Thunder", komandantëve të togjeve, tri kompanive ekzistuese dhe njësisë operative "Task Force Thunder" të Zonës së përgjegjësisë për Gjilan, Dardanë dhe Artanë.
- Me datën 14/03/2008 Drejtori komunal për arsim dhe kulturë, Ismajl Kurteshi ka vizituar paralelen e ndarë të shkollës rome "Vuk Karagjiq", në Gjilan, me ç'rast ka biseduar me mësimdhënësit serb e rom, të cilët këtu punojnë me planprograme të Serbisë, ndërsa marrin paga të dyfishta, nga Beogradi dhe nga buxheti i Kosovës. Më se 76 nxënës të komunitetit rom, nga klasa 0 deri në të tetën, i vijojnë mësimet në një objekt privat, por të përshtatur mirë për nevojat e shkollës dhe ku punohet në dy ndërrime.
- Me datën 10/04/2008 është Organizuar nga Drejtoria për Arsim dhe Kulturë, në Gjilan, në lokalet e Qendrës Didaktike, është mbajtur tryeza e rrumbullakët me temën "Mundësitë e hapjes së drejtimeve të reja në shkollat e mesme profesionale të Gjilanit", ku kanë marrë pjesë zyrtarë të Arsimit dhe Kulturës në Gjilan dhe Dardanë, drejtorë të shkollave të mesme, përfaqësues të ndërmarrjeve private dhe të tjerë.
- Me datën 12/04/2008, mbahet takimi i bashkëpunimit ndërkufitarë (GJPK) Gjilani, Kumanova dhe Presheva, si komuna fqinje në regjion janë pajtuar për thellimin e bashkëpunimit ndërkufitar, duke kërkuar relativizmin e kufijve shtetëror në qarkullimin e njerëzve, mallrave dhe ideve. Kryetarët e këtyre tri komunave, Qemajl Mustafa, Zoran Domjanovski dhe Ragmi Mustafa, në një takim të përbashkët në Gjilan, ku kanë marrë pjesë edhe këshilltarët e bllokut politik shqiptar në Kumanovë, Zija Sahiti (BDI) e Feriz Dervishi (PPD), kanë thënë se Gjilani, Kumanova dhe Presheva, si komuna fqinje, do të vazhdojnë bashkëpunimin, pa pasur nevojë të implikohen autoritet e vendosjes, qoftë nga Brukseli, Gjeneva apo ndonjë qendër tjetër, duke treguar kështu para botës vlera të civilizimit evropian, të cilat janë të mundura edhe në këto nivele.
- Me datën 16/04/2008 Kuvendi Komunal i Gjilanit ka miratuar propozim-statutin e Komunës, me disa vërejtje parimore të grupit të këshilltarëve të LDK-së për riformulimin e disa neneve të këtij dokumenti, por që nuk cenon draftin e komisionit, përderisa këshilltarët e LDD-së kanë abstenuar nga votimi, duke ngelur pranë qëndrimit të tyre të mëhershëm.

- Me datën 17/04/2007 Kryetari i Komunës "Bajram Pasha" nga Republika e Turqisë, Hysein Burge i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka vizituar Gjilanin, me ç'rast është pritur nga kryetari Qemajl Mustafa dhe drejtori i Arsimit, Ismajl Kurteshi. Qëllimi i kësaj vizite të mysafirëve nga Turqia, siç e thanë ata, ishte njohja me gjendjen në komunën e Gjilanit si dhe me nevojat që ka sot Komuna e Gjilanit.
- Me datën 18/04/2008, në kuadër të javës së bibliotekës shqiptaro-amerikane në Kosovës, të organizuar nga Biblioteka Kombëtare Universitare dhe Ambasada Amerikane në Kosovë, të enjten në Gjilan, në bibliotekën ndërkomunale "Fan Noli" u përurua programi i automatizuar bibliotekar "Alph 500".
- Me datën 23/04/2008 Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Fatmir Limaj, përuroi në Bresalc fillimin e punimeve në projektin e nënkalimit për nxënësit e shkollës fillore "Ibrahim Uruqi". Ky nënkalim është një nga nevojat e kamotshme të këtij lokaliteti, të këtyre banorëve dhe është në përputhshmëri të plotë me politikat e Ministrisë së Transportit për të eliminuar pikat e zezë dhe për të ngritur sigurinë në komunikacion. "Ne kemi thënë më herët se siguria e qytetarëve është prioritet kryesor yni dhe të gjitha politikat tona qojnë kah eliminimi apo zvogëlimi i rrezikut për qytetarët tanë anekand Kosovës", ka thënë ministri Limaj.
- Me datën 27/04/2008 Ministri i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës, Lutfi Zharku ka vizituar Komunen e Gjilanit, ai ka premtuar politika më të favorshme fiskale, gjatë vizites është takuar me kryetarin e Komunës, Qemajl Mustafa si dhe me komunitetin e biznesit.
- Me datën 29/04/2008 përmes një letre dërguar Kuvendit Komunal të Gjilanit, përfaqësues të fshatit Stançiq të komunës së Gjilanit kanë shpreh shqetësimet e tyre lidhur me mosdefinimin e kufirit Kosovë-Maqedoni. Në letrën e tyre, ndër të tjera thuhet: "Ne si qytetarë të fshatit Stançiq shprehim shqetësimin tonë lidhur me paqartësitë që një kohë të gjatë po na përcjellin lidhur me mosdefinimin e çështjes së kufirit Kosovë – Maqedoni".
- Me datën 30/04/2008 Komuna shpalli 10 fermeret me të mire, në mesin e shumë fermerëve të dalluar, dhjetë syresh janë shpall fermer të vitit, të cilët nga Kuvendi Komunal janë nderuar me mirënjohje dhe shpërblime tjera: Imer Muji (Bresalc) – shpeztari, Metush Neziri (Lipovicë) – blegtori e imët, Ekrem Mehmeti (Cernicë) - pemëtari, Isa Jakupi (Livoç i Epërm) - blegtori, Enver Ismajli (Përlepnicë) - blegtori dhe pemëtari, Ibrahim Rahimi (Malishevë) - kopshtari, Basri Haziri (Llashticë) - lavërtari, Ibrahim Aliu (Zhegër) - kultivues i pemëve të imëta, Jovica Petroviq (Budrigë) - blegtori dhe lavërtari, Nikola Jovaniviq (Partesh) - kopshtari.
- Me datën 1-3 maj 2008: organizohet manifestimi "Ditët e Agimit 2008" mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës, Qemajl Mustafa dhe realizohet nga Drejtoria për Arsim dhe Kulturë si dhe Bashkësia Vendore e Zhegrës .
- Me datën 02.05.2008 Kryetari i Gjenevës, Patrice Mugny me bashkëpunëtorët e tij ka vizituar Gjilanin, ku ka premtuar ndihmë në disa projekte nga fusha e arsimit dhe kulturës. Mugny tha se vizita e tij në Gjilan bëhet me qëllim të koordinimit me udhëheqjen komunale rreth të dy-tri projekteve, të cilat do të realizohen në një të ardhme të afërt, ndërkohë që gjilanasve do t'iu mundësohet edhe një takim me komunitetin zviceran në Gjenevë, për të tërhequr investitorë në qytetin e tyre. Ndryshe kreu i Gjenevës, Mugny e ka vlerësuar lartë komunitetin shqiptar në Gjenevë, i cili në masë të konsiderueshme vjen nga qyteti i Gjilanit, sikurse janë edhe Mirishahe Limani-Hiler dhe Naim Malaj.
- Me datën 05.05.2008 Grupi komunal për kthim i komunës së Gjilanit ka miratuar strategjinë komunale për kthim, që parasheh realizimin e një projekti në Zhegër, fazën e tretë të kthimit të romëve në lagjen "Dheu i Bardhë" si dhe kthimin e të zhvendosurve të marsit 2004, përkatësisht një ndihmë për këto familje.
- Me datën 06.05.08 Fëmijët e çerdhës që gjendet në lagjen "Kamnik" në afërsi të ish "Tekstilit", ishin më të gëzuarit dhe me padurim prisnin hapjen e parkut të lodrave në kopshtin e tyre, të dhuruar nga KFOR-i turk, respektivisht gjeneralit Ugur Tarcin. Mirëseardhe dhe falënderim të veçantë për këtë investim të popullit turk, për fëmijët dhe gëzimin e tyre që ka sjell ky projekt, kanë shpreh kryetari i Komunës Qemajl Mustafa, drejtori i Arsimit Ismajl Kurteshi dhe drejtoresha e kësaj çerdheje znj. Sanije Elezi.
- Me datën 08/05/2008 Gjenerali amerikan, John Davoren e ka vlerësuar të qetë situatën e sigurisë në sektorin e lindjes, në një takim me kryetarin e Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa. Të dy bashkëbiseduesit janë shprehur të bindur se edhe në ditët që vijnë, me angazhime të përbashkëta, kjo qetësi do të ruhet dhe avancohet. Përndryshe, gjenerali Davoren dhe kreu i Komunës, Mustafa kanë folur për shumë çështje aktuale në komunë, regjion dhe Kosovë, në përgjithësi, duke filluar nga klima politike, raportet me komunitetet, në veçanti me atë serb, procesin e kthimit, decentralizimin, zgjedhjet në Serbi, që do të mbahen më 11 maj të këtij viti dhe të tjera.
- Me datën 09/05/2008 në Gjilan, për nder të 9 Majit - ditës së Bashkimit Evropian, është hapur një ekspozitë përpara objektit të ekzekutivit të Komunës. Në të vërtetë, Zyra për Demokraci Lokale e Këshillit të Evropës (ADL) si dhe Kuvendi Komunal, përkatësisht zyra për projekte do ta shënojnë me disa aktivitete këtë përvjetor, të titulluar "Muaji i Bashkimit Evropian" në Gjilan, prej 2 deri më 12 maj do të mbahet konkursi në vizatim "Unë dhe Bashkimi Evropian", më 9 dhe 10 maj hapet ekspozita e frizës së Bashkimit Evropian, më 14 maj bëhet ndarja e çmimeve të konkursit dhe kuizit, ndërsa prej 15 deri më 31 maj mbahet ekspozita e vizatimeve në ADL.
- Me datën 09/05/2008 për nder të ditës së shkollës, nxënësit e shkollës teknike "Mehmet Isai" në Gjilan, të vitit XIII/1, drejtimi i arkitekturës, kanë organizuar një ekspozitë me punime individuale dhe grupe. Projekte të objekteve të ndryshme të banimit, maketa, madje edhe të shkollës së tyre, në përmasa objektive, të ekspozuara para teatrit të qytetit, kanë zgjuar interesimin e vizitorëve të shumtë.

- Me datën 09.05.2008, Kryetari i Ulqinit, Gëzim Hajdinaga, ofertën turistike të qytetit të tij bregdetar, mbrëmë e ka promovuar edhe në Komunën e Gjilanit, ku është pritur nga përfaqësues të Qeverisë komunale.
- Me datën 10/05/2008 në Gjilan, në praninë e përfaqësuesve të USAID-it, zyrtarëve komunalë si dhe një numri të konsiderueshëm të afaristëve, u bë finalizimi i marrëveshjes ndërmjet USAID-it, në bashkëpunim me KEK-un dhe kompanisë për prodhimin e kabllove elektrike "CF-Progresi" për furnizim 24 orë me energji elektrike.
- Me datën 12/05/2008, me rastin e vdekjes së Zijadin Salihut, ish-delegat i Kuvendit të Kosovës, në shenjë nderimi për jetën dhe veprën e tij, Kuvendi Komunal në Gjilan, mbajti mbledhje komemorative, ku morrën pjesë këshilltarët komunalë, familjarë, përfaqësues të qeverisë komunale, shokë dhe miq të të ndjerit, të cilët, me një minutë heshtje nderuan veprën dhe kujtimin për të.
- Me datën 13/05/2008, Ministri i Shëndetësisë në Qeverinë e Kosovë, Alush Gashi është shprehur i kënaqur me punën e mirë që po bën udhëheqja e Spitalit Regjional të Gjilanit, ku ai ka marrë pjesë në përrurimin e shërbimit të endoskopisë në repartin e ORL-së.
- Me datën 19/05/2008, në përvjetorin e nëntë të rënies së dëshmorit të kombit, shkolla fillore në Malishë ka marrë emrin e ri e të merituar "Avdullah Tahiri". Pllakën e vendosur në ballë të shkollës, me emrin e dëshmorit Avdullah Tahiri, e kanë zbuluar kryetari i Komunës, Qemajl Mustafa, e bija e dëshmorit Albana Tahiri, bashkëvendësja Shqipe Mehmeti-Selimi si dhe drejtori i shkollës, Haki Sahiti.
- Me datën 20/05/2008, zëvendësministri i MAPL Shpen Trdevaj, së bashku me bashkëpunëtorët e tij ka vizituar Komunën e Gjilanit, me synim të realizimit të një takimi me strukturat qeverisëse lokale, lidhur me çështjet të cilat kanë të bëjnë me funksionimin e qeverisjes lokale në Gjilan.
- Me datën 21/05/2008, Nën organizimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, në Gjilan, është mbajtur takimi i parë i kolegjiut të drejtoreve komunalë të arsimit, i kryesuar nga Ismail Kurteshi, ku është prezantuar rregullorja e punës, plani i punës si dhe janë trajtuar çështje tjera të përbashkëta të arsimit në komunat e Kosovës.
- Me datën 26/05/2008 Kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa, ka udhëtuar për në Selanik të Greqisë, për të marrë pjesë në një seminar për planifikimin hapësinor. Në këtë seminar, ku do të trajtohen planet zhvillimore urbanistike komunale si dhe zbatimi i tyre në praktikë, marrin pjesë, bashkë me UN-HABITAT-in, përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe kryetarë të disa komunave tjera të Kosovës. Pas përfundimit të vizitës në Greqi, më 29 maj, kryetari i Komunës Qemajl Mustafa, bashkë me një përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe me menaxherin e Kompanisë publike "Pastrimi" udhëton për një vizitë pune në Frankfurt të Gjermanisë. Qëllimi i këtij udhëtimi është vizita në fabrikën për riciklim të mbeturinave, që është produkt i kompanisë "Global Energy-Invest" nga Gjermania. Vizita në Gjermani bëhet për të arritur një marrëveshje, e cila është shumë afër, për instalimin e një fabrike të këtij lloji për riciklim të mbeturinave në Gjilan, që ka vlerën 5 milion €.
 - Me datën 30/05/2008 Komuniteti për Komunitete në Gjilan, duke i marrë parasysh shqetësimet e një numri të qytetarëve serbë, rreth disa shërbimeve administrative, të cilat ata nuk po mund t'i realizojnë nga 17 shkurti e këtej, shkaku i bojkotit të punës nga zyrtarët e këtij komuniteti, duke llogaritur këtu edhe Zyrën Lokale të Komuniteteve, i ka rekomanduar Kuvendit Komunal që të vendos për hapa tjerë, nëse këta shërbyes civilë refuzojnë të kthehen edhe më tutje në vendet e tyre të punës. Komiteti për komunitete propozon konkurs të ri, nëse zyrtarët serbë nuk kthehen në punë .
 - Me datën 31/05/2008 Me iniciativë të profesoreshës amerikane, Jane Nicholson, përkrahjen e Kuvendit Komunal të Gjilanit si dhe të KFOR-it amerikan, është kryer një aksion për pastrimin e hapësirës gjelbëruese në lagjen "Dardania" të qytetit. Aktiviteti kishte si qëllim senzibilizimin e banorëve të lagjes dhe në përgjithësi qytetarëve të Gjilanit, për rëndësinë e madhe që ka mbajtja e pastërtisë nëpër hapësirat publike.
 - Me datën 01/06/2008 Rreth pesëdhjetë vogëlushë të moshës 5-6 vjeçare dhe rreth 200 nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga komunat Gjilan, Preshevë, Kumanovë dhe Tërgovishtë, do të mblidhen në Gjilan, më 1 qershor, për të shënuar ditën ndërkombëtare të fëmijëve.
 - Më 1 qershor 2008, është përruruar edhe fillimi i projektit për asfaltimin e rrugës Ponesh – Zhegoc, me gjatësi mbi 5 km. Fillimin e punimeve të projektit, solemnisht e kanë bërë ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Fatmir Limaj dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Qemajl Mustafa.
 - Ne fillim të muajit qershor një : Delegacioni nga komuna e Gjilanit, nën udhëheqjen e Bujar Nevzatit, përgjegjës i Kabinetit të kryetarit, Ismet Maliqi, drejtor për Buxhet dhe Financa, Omer Daku, drejtor i Urbanizmit, Fadil Gashi, këshilltar komunal nga AAK, Arben Mehmeti, shef i GK nga LDK si dhe Sabri Tahiri, shef i Komisionit të Ekspertëve të Komunës së Gjilanit, me ftesë të kryetarit të Komunës së Yalldërmit të Turqisë, Ozgen Keskin, kanë qëndruar për një vizitë zyrtare dy ditëshe në komunën këtë qytet.
 - Me datën 03/06/2008 Vizita e përfaqësuesit të ambasadës austriake në Prishtinë, Andreas Fritz, në Gjilan, kishte të bënte me investimet e Qeverisë së Austrisë dhe Zvicrës në projektet për furnizim me ujë në komunën e Gjilanit, konkretisht për tri projektet e ardhshme në zonat rurale - Zhegër, Miresh dhe Llovçë. Vlera e këtyre projekteve kap shifrën rreth gjysmë milioni €, investim ky i përbashkët i Qeverisë Austriake dhe Komunës së Gjilanit.
 - Me datën 12/06/2008 : Zenun Pajaziti, ministër i brendshëm në Qeverinë e Kosovës ka thënë në Gjilan se nuk ka shembull më të mirë se kjo komunë për të dëshmuar se si funksionon pushteti dhe shoqëria multietnike. Ministri Pajaziti, në një konferencë me gazetarë, pas takimit me kryetarin e komunës, Qemajl Mustafa, ku ai shoqërohej edhe nga zëvendëskomisari i policisë, Sheremet

Ahmeti si dhe këshilltari ligjor në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Xhef Tomas, e ka quajtur edhe pak simbolike këtë vizitë në Gjilan, në prag të hyrjes në fuqi të kushtetutës së Republikës së Kosovës.

- Me datën 15/06/2008 : Kryetari i komunës z.Qemajl Mustafa në emër të Kuvendit Komunal të Gjilanit dhe në emrin e tij personal u uron të gjithë qytetarëve të Komunës së Gjilanit nëntëvjetorin e çlirimit të qytetit dhe hyrjen triumfale të forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Gjilan bashkë me aleatët.
- Me datën 16/06/2008: Komuna e Gjilanit ka mbajtur debtin e parë me qytetarë për këtë vit, ku kreu i saj Qemajl Mustafa ka prezentuar angazhimet dhe sukseset e kësaj qeverie për këtë periudhë, duke i inkurajuar qytetarët që t'i kryejnë obligimet e veta dhe t'i nxisin edhe të tjerët përreth tyre që të mos hamenden për të paguar tatimin në pronë, sepse ajo është një taksë, e cila iu kthehet qytetarëve përmes investimeve.
- Me datën 26/06/2008, Autokombajnerët e Gjilanit janë marrë vesh për një çmim prej 120 € për korren-shirjen e një hektari me drithëra të bardha, duke arritur kështu një kompromis ndërmjet çmimit rekomandues të Qeverisë së Republikës së Kosovës prej 90 € për hektarë si dhe atij prej 150 €, të kërkuar nga shumica e pronarëve të kombajnave.
- Me datën 27/06/2008, Komiteti për Politikë dhe Financa ka shqyrtuar dhe i ka rekomanduar për seancën e fundit të KK-së : Iniciativa për anëtarësimin e Komunës së Gjilanit në Asociacionin e Komunave Turke në Botë, ka qenë rekomandimi i parë i Komitetit për Politikë dhe Financa, një tjetër propozim, i cili ka tërhequr më shumë vëmendjen e anëtarëve të këtij komiteti, ka qenë propozim-vendim për ushtrimin e veprimtarisë së bizneseve hoteliere në territorin e Komunës dhe në kompleksin pranë shkollave të mesme.
- Me datën 02/07/2008, Organizata Turke - TIKA dhe përfaqësues të Administratës për zhvillimin e ndërmarrjeve të mesme e të vogla të Turqisë, kanë vizituar sot Gjilanin, me ç'rast kanë takuar kryetarin e Komunës, disa kompani private prodhuese dhe segmente tjera institucionale dhe të ekonomisë së Gjilanit.
- Me datën 04/07/2008, është mbajtur seanca e radhës e KK-së (e fundit për këtë gjysmëvit), në të cilën janë marrë disa vendime me rëndësi. Iniciativa e këshilltarit komunal, Fadil OSMANI, për anëtarësimin e Komunës së Gjilanit në Asociacionin e Komunave Turke në Botë, të cilën KPF e kishte rekomanduar për këtë seancë si propozim-vendim, është mbështetur nga të gjithë dhe me këtë është formalizuar vullneti i KK-së së Gjilanit për anëtarësim në këtë asociacion.
- Me datën 07/07/2008, Nisë ndërtimi edhe i urës në Liviq të PoshtëmPërveç projekteve që po realizohen në asfaltimin e rrugëve në qytet dhe fshatra, në Komunën e Gjilanit, po ndërtohen edhe ura që shkurtojnë dukshëm rrugët dhe lidhin mes vete disa fshatra dhe vendbanime të Komunës.
- Me datën 15/07/2008, koncert i madh muzikor për bashkatdhetarë, me moton “Bashkatdhetarë – mirë se erdhët në Kosovën e Pavarur” duke filluar nga ora 20:00, para Teatrit të Qytetit, mbahet Koncert muzikor për bashkatdhetarët tane .
- Me datën 21/07/2008 Gjilani bëhet me stacion sismologjik, detyra e këtij stacioni është të bëjë monitorimin e aktivitetëve sizmike në territorin e shtetit të Kosovës, rajonit dhe më gjerë.
- Me datën 23/07/2008, Komuna e Gjilanit ka mbajtur dëgjimin e parë publik për qarkoren buxhetore 2009-2011, për t'iu dhënë mundësi qytetarëve që të njihen me propozimet e drejtorive, por edhe t'i paraqesin sugjerimet e tyre, duke u bërë kështu bashkëpjesëmarrës në vendimarrjet më të rëndësishme, siç është buxheti. Ismet Maliqi, drejtor për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, ka thënë se, në bazë të kësaj kornize buxhetore, të përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Komuna e Gjilanit, në vitin 2009 do të ketë një buxhet prej 12.349.008 €, i cili do të përfutojë një rritje të ndjeshme në dy vitet vijuese. Kështu, buxheti i vitit 2010 parashihet të jetë 12.724.559 €, ndërsa ai i vitit 2011- 13.086.824 €.
- Me datën 26/07/2008, Vihet gurthemeli i shkollës fillore “Agim Ramadani” në fshatin Zhegër, Zëvendëskryeministri i Qeverisë së Kosovës, Hajredin Kuqi, duke përgëzuar familjen Ramadani dhe familjet e dëshmorëve tjerë, për nisjen e punimeve për shkollën e re, e cila mban emrin e dëshmorit të kombit, Agim Ramadani, tha se Qeveria e Kosovës po i mban premtimet e dhëna që arsimin do ta trajtojë si prioritet.
- Me datën 12/08/2008, kryetari i Komunës Qemajl Mustafa ka takuar komandantin e forcave shumëkombëshe të Lindjes, gjeneralin Larry D. Kay, me të cilin kanë biseduar për gjendjen aktuale në komunën e Gjilanit.
- Me datën 31/08/2008, kanë udhëtuar për në Itali shtatë student nga komuna e Gjilanit, të cilët me organizimin dhe mbështetjen financiare të komunës, janë përfituesit e parë të bursës komunale për studime në universitetin e Italisë. Pjesë e bashkëpunimit mes KK-së së Gjilanit dhe Karitasit të Kosovës, ishte edhe përfaqësuesi i Organizatës Italiane “Shën Exhidio”, z. Don Sandro, i cili ofroi donacion për disa nxënës të komunës sonë duke i ofruar mundësinë e studimeve në disa prej fakulteteve të Universitetit të Italisë. Lista e studentëve bursistë që kanë udhëtuar dje për në Itali: Alketa Spahiu, Arbnor Ajvazi, Albulena Salihu, Batishahe Selimi, Besart Sylja, Shkurte Berisha dhe Valmira Abdullahu.
- Me datën 01/09/2008, Të gjitha shkollat e komunës së Gjilanit sot ishin të përgatitura, si kurrë më parë, për të filluar punën me kushte shumë më të mira, po ashtu Me rastin e fillimit të muajit të agjërimit - Ramazanit, udhëheqësit komunal e kanë vizituar edhe selinë e Bashkësisë Islame në Gjilan .
- Me datën 27/09/2008, Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z.Hashim Thaçi, i shoqëruar nga ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor z.Mahir Jakcilar dhe zëvendësministri i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, z. Adem Grabovci, gjatë vizitës në Anamoravë me datën 27/09/08 fillimisht është ndalur në qytetin e Gjilanit, me këtë rast kryeministri Thaçi solemnisht u ka dorëzuar çelësat e Qendrës së Banimit Social 26 familjeve në nevojë të kësaj komune.
- Me datën 15/10/2008, mbahet akimi i përfaqësuesve të komunave të rajonit të Gjilanit (Gjilan, Ferizaj, Dardan, Viti, Shterpce, Hani i Elezit dhe Kaçanikut) takimi ka pas për qëllim hapjen e Agjencisë për Zhvillim Rajonal Ekonomik .

- Me datën 18/10/2008, në fshatin Velekincë është peruruar fabrika e ujit e financuar nga Qeveria Zvicrane, projekti ka pas perqellim shtimin e resurseve ujore, prej tani qyteti i gjilanit dhe dy fshatrat Velekica dhe Pasjani do të kenë ujë të pijshëm më shumë. Qeveria Zvicrane deri me tani ka financuar në Komunen e Gjilanit mbi 30 mil €, në ceremoninë e perurimit të fabrikës së ujit kanë marrë pjesë : Fatmir Sejdiu, kryetar i Kosovës, Hashim Thaqi, Kryeministër i Kosovës dhe Ambasadori i Zvicerrës.
- Me datën 30/10/2008, Gjilani bëhet me plane të reja zhvillimore, PZHK dhe PZHU janë dokumente shumë të rëndësishme për Komunen e Gjilanit, vlera e këtyre projekteve është 198.000 €.
- Me datën 21/11/2008, Komuna e Gjilanit miraton statutin e ri. në përputhje me LVL – të Ministrisë së Pushtetit Lokal, në bazë të këtij statuti Komuna e Gjilanit do të ketë 11 drejtori.
- Me datën 27/11/2008, sektori për kulturë organizon Akademi Shkencore në sallën e teatrit, kushtuar 100 vjetorit /1908-2008/ të Kongresit të Manastirit / 100 vjet ABC/
- Me datën 04/12/2008, me moton “ të vazhdojmë së bashku “ Komuna e Gjilanit ka organizuar një takim falenderues për të gjitha Organizatat Nderkombëtare dhe Lokale, Institucionet diplomatike /ambasadat/, Qeverinë e Kosovës, TMK, SHPK që kanë ndihmuar Komunën e Gjilanit gjatë viteve 1999 - 2008.

Lista e projekteve !

Skema e projekteve : te kontraktuara – të papërfunduara ne vitin 2008

Nr.	Emri i projektit	Te dhëna tjera	
		Vlera Totale €	Operatori ekonomik
01	Asfaltimi i rrugës Dardania II rruga e V-të, rruga Naser Azemi, rruga te tregu si dhe disa rrugica neqytet	182,244.20	Euro Trans Gjilan
02	Asfaltimi i rrugëve në fsh.Përlepnice, fshatin Velekicë, pjesa e rrugëve Kodra e Dëshmorëve dhe rruga Fadil Jakupi (krahu 1 dhe 2)	111,210.89	Bejta Comerc Gjilan
03	Asfaltimi i rrugëve në fsh.Zhegër,në Bresalc (te Hoxhovit) dhe rruga në Verbicë të Kmetocit	334,968.46	Bejta Comerc Gjilan
04	Asfaltimi i rrugëve: Malësia, Fatmir Ibishi, rruga prapa Postes Kryesore, Ali Huruglica dhe Hasan Tasini	266,241.00	Çlirimi Liv. i Epërm
05	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Cërrnicë	97,742.80	Plan Ing Gjilan
06	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Koretishtë	54,730.00	Bejta Comerc
07	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Pogragjë	50,251.50	Euro Trans Gjilan
08	Ndertimi i objekteve montuese Qendra Zejtare	76,600.86	MEGA Gjilan
09	Rregullimi i objektit te Caritas Kosoves	26,499.58	MABB Construction
10	Meremetimi i katit përdhësë në objektin e konviktit të nxënësve dhe studentëve	65,140.89	Gjokonsulting Viti
11	Meremetimi i objektit të palestres së sporteve te shkollat e mesme - palestra te shkolla e mesme M. Barleti”	58,498.83	AREA Hodonovc
12	Mirëmbajtja e rrugëve te rendit te tretë	73,640.00	Euro Trans
13	Rregullimi i kulmit te soliterit (P+13)	27,080.00	Vali AL PVC
14	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve	33,202.20	Magjistratja
15	Ndertimi i terenit sportivë ne fshatin Mireshe	35,872.35	Tekno Ing
16	Furnizimi me material per aneksin e shkolles Stanishor	31,770.00	Prespektiva
17	Ndertimi i rrethrotullimit para objektit te Gjykates	46,519.00	RSM Prishtinë
18	Optimalizimi dhe shenjëzimi Horizontal dhe Vertikal i Komunikacionit ne Komunen e Gjilanit	74,197.00	Bejta Comerc Gjilan
TOTALI €		1,646,409.56	

Përgatitur nga : Fadil OSMANI, Zyrtar për projekte

E-mail : fadilosmani02@yahoo.com